


ROADMAP PRACTITIONER TOOLS



DIREKTIVA E BE-së MBI MASAT MBROJTËSE PROCEDURALE PËR FËMIJËT QË JANË TË DYSHUAR APO AKUZUAR NË PROCEDURA PENALE

MANUAL MBI ZBATIMIN



Rreth “Fair Trials”

“Fair Trials” është një organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me zyre në Londër, Bruksel dhe Uashington, D.C., e cila është e fokusuar në përmirësimin e të drejtës për gjykim të drejtë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Puna e kësaj organizate bazohet në besimin se gjykimet e drejta janë një nga gurthemet për një shoqëri të mirëfilltë: kjo parandalon rrënimin e jetës nga gabimet e drejtësisë dhe e bënë shoqërinë më të sigurt duke kontribuar në sistemin transparent dhe të besueshëm të drejtësisë për të ruajtur besimin e publikut. Megjithëse në parim njihet si një e drejtë universale, në praktikë e drejta themelore e njeriut për gjykim të drejtë abuzohet në mënyrë rutinore. Puna e “Fair Trials” bënë një kombinim mes: (a) ndihmës dhënë të dyshuarve që të kuptojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre; (b) ndërtimin e një rrjeti të mbrojtësve të gjyqësorit të drejtë të angazhuar dhe të informuar (përfshirë OJQ-të, avokatët dhe akademikët); dhe (c) luftimin e shkaqeve themelore të gjyqësorit të padrejta nëpërmjet hulumtimit, procesit gjyqësor, avokimit politik dhe fushatave.

Rreth Panelit Këshillëdhënës të Ekspertëve Ligjor

Paneli Këshillëdhënës i Ekspertëve Ligjorë (ose LEAP) është një rrjet ekspertësh evropian në drejtësinë penale dhe të drejtat e njeriut që punon për promovimin e një bashkëpunimi gjyqësor të drejtë dhe efektiv brenda Evropës. Aktualisht ekzistojnë 155 anëtarë organizativ, me përfaqësues nga firmat ligjore, OSHC-të dhe institucionet akademike, duke mbuluar të gjitha 28 shtetet anëtare të BE-së.

Përmes koordinimit të “Fair Trial”, LEAP është në gjendje të ofrojë një pikëpamje profesionale mbi një gamë të gjerë temash të drejtësisë penale të BE-së, duke rritur gjithashtu bashkëpunimin ndërmjet mbrojtësve të të drejtave të njeriut në punën ndërkufitare. Rëndësia e LEAP është pranuar nga BE, e cila ka njohur kontributin e rrjetit në Drejtësinë e BE-së.

“Fair Trials” dhe LEAP dëshirojnë t’i shprehin falënderime të veçanta **Stephanie Rap** nga Universiteti i Leidenit për ofrimin e ekspertizës mbi të drejtat e fëmijëve dhe për ndihmën në hartimin e këtij manuali.

Për informacione të mëtejshme, ju lutemi kontaktoni:

Ralph Bunche
Drejtori Rajonal për Evropë
+32 (0)24242354

ralph.bunche@fairtrials.net

Silvia Lorenzo Perez
Asistente për Çështje Ligjore dhe
Politika
+32 (0)2425 8447

silvia.lorenzoperez@fairtrials.net

Gianluca Cesaro
Zyrtare për Komunikime
+32 (0)24258447

gianluca.cesaro@fairtrials.net

Ky publikim është mbështetur financiarisht nga “Programi për Drejtësi (Justice Programme)” i Bashkimit Evropian. Përmbajtjet e këtij publikimi janë nën përgjegjësinë e vetme të “Fair Trials International” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të nënkuptohen se pasqyrojnë pikëpamjet e Komisionit Evropian



Tabela e përmbajtjes

Përmbajtja

MANUALI MBI DIREKTIVËN PËR FËMIJËT	5
I. HYRJE DHE HISTORIKU.....	5
A. Fushëveprimi dhe objektivat	5
B. Përkufizimet.....	5
C. Konceptet themelore në drejtësinë për të mitur	5
D. Udhërrëfytyesi për të Drejtat Procedurale	7
II. DIREKTIVA MBI FËMIJËT	8
A. Direktiva mbi Fëmijët.....	8
B. Dispozitat e direktivës.....	9
III. PARIMET KYÇE NË DIREKTIVËN MBI FËMIJËT	18
A. Fushëveprimi i drejtësisë për të mitur.....	18
B. Interesat më të mira të fëmijës	19
C. Pjesëmarrja efektive	21
D. E drejta për ndihmë juridike	23
E. Mbrojtja e privatësisë dhe konfidencialitetit.....	26
IV. ZBATIMI PRAKTIK I DIREKTIVËS PËR FËMIJËT.....	27
A. Arrestimi dhe marrja në pyetje nga policia	27
E drejta për ndihmë juridike	28
Pjesëmarrja efektive	30
E drejta për t'u dëgjuar	30
E drejta e informimit	31
Privatësia dhe konfidencialiteti.....	33
Diversioni	33
B. Paraburgimi.....	34
Masat e zgjidhjes së fundit dhe për periudhën më të shkurtër të përshtatshme kohore.....	34
E drejta e informimit	38
Mirëqenia.....	38
C. Procedurat gjyqësore.....	39
E drejta për informim.....	39
E drejta për t'u dëgjuar	41

Mbrojtja e privatësisë	42
Pas seancës dëgjimore	42
VI. PËRFUNDIM	43

MANUALI MBI DIREKTIVËN PËR FËMIJËT

I. HYRJE DHE HISTORIKU

A. Fushëveprimi dhe objektivat

1. Të drejtat e fëmijëve në sistemet e drejtësisë për të mitur janë zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme përgjatë disa dekadave përmes një shumëllojshmërie të instrumenteve ligjore ndërkombëtare dhe evropiane. Shumica e parimeve kyçe që mbështesin drejtësinë për të mitur dhe të drejtat e fëmijëve të dyshuar dhe akuzuar janë të përfshira në këto standarde, ku vetëm disa prej tyre janë të detyrueshme dhe drejtpërdrejtë të zbatueshme. Direktiva 2016/800 mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë të dyshuar apo akuzuar në procedurat penale (**Direktiva mbi Fëmijët**), e cila është miratuar në vitin 2016, është dizajnuar të riafirmoj parimet e njëjta në kuadër të një mase të detyrueshme ligjore në të cilën praktikuesit e BE-së mund të referohen më me lehtësi.
2. Ky manual është udhëzues për avokatët dhe praktikuesit e tjerë që punojnë me fëmijët që janë në konflikt me ligjin, veçanërisht pasi ata përdorin **Direktivën mbi Fëmijët** në proceset gjyqësore vendore. Ai ofron një përmbledhje të dispozitave përkatëse të direktivës, si dhe informacione më të detajuara në lidhje me mënyrat në të cilat mund të përdoret direktiva për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin në faza të ndryshme të procedurave penale.
3. Shpresojmë që gjithashtu do të inkurajojë anëtarët e LEAP dhe rrjetet e tyre në identifikimin e problemeve të vazhdueshme me ligjin dhe praktikën kombëtare që mund të adresojë direktiva, me qëllim të ofrimit të kornizës për zhvillimin e strategjive për ofrimin e informacioneve për reformimin e mëtejshëm të ligjit dhe praktikës në nivel vendor dhe rajonal.

B. Përkufizimet

4. Fillimisht, disa nga termet e përbashkëta në mesin e standardeve ndërkombëtare duhet të përkufizohen:
 - “Fëmijë” nënkupton çdo person nën moshën 18 vjeçare (shih nenin 1 të Konventës së OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve (**KDF**) dhe diskutimin në seksionin III më poshtë).
 - “Fëmijë në konflikt me ligjin” janë të gjithë fëmijët që janë të dyshuar apo akuzuar në procedura penale.
 - “Drejtësia për të mitur” nënkuptohet si grupi i standardeve që e njohin fëmijën në konflikt me ligjin si qenie njerëzore me të drejtë për gjykim të drejtë, por gjithashtu edhe me status të veçantë që kërkon trajtimin specifik të fëmijës. Kjo qasje njihet në nenin 40 të KDF, dispozita kryesore për drejtësinë për të mitur.
 - “Avokat” nënkupton çdo person i cili, në përputhje me ligjin kombëtar, kualifikohet dhe ka të drejtë t’iu ofrojë të dyshuarve apo të akuzuarve këshillë dhe ndihmë juridike.

C. Konceptet themelore në drejtësinë për të mitur

5. Koncepti i drejtësisë për të mitur është zhvilluar dhe rafinuar përmes një numri të instrumenteve ligjore ndërkombëtare, duke përfshirë ato të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe Këshilli i Evropës. Instrumentet më me ndikim nga këto instrumente u miratuan nga OKB-ja në vitet e 80-ta dhe përfshijnë:
- Rregullat Minimale të Standardeve të OKB-së për Administrimin e Drejtësisë për të Mitur (**Rregullat e Pekinit**, 1985);
 - Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (**KDF**, 1989)
 - Rregullat për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria (**Rregullat e Havanës** 1990); dhe
 - Komentin e Përgjithshëm nr. 10 mbi të drejtat e fëmijëve në drejtësinë për të mitur, i miratuar nga Komiteti i OKB-së për të Drejtat e Fëmijës (**Komiteti i KDF**).
6. Standarde të ngjashme janë zhvilluar më pas nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës (**KiE**) për të fuqizuar më tej mbrojtjen për fëmijët në konflikt me ligjin. Këto përfshijnë:
- Rregullat Evropiane për shkelësit e mitur që i nënshtrohen sanksioneve apo masave (**Rregullat Evropiane**, 2008);
 - Udhëzimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve (**Udhëzimet**)¹. As Rregullat e as Udhëzimet Evropiane nuk janë të detyrueshme, por kanë luajtur një rol të rëndësishëm në formësimin e jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**GJEDNJ**).²
7. Edhe pse vetëm KDF është e detyrueshme, ky rrjet i instrumenteve të “ligjit të butë” ka përcaktuar konceptet kryesore që mbështesin **Direktivën mbi Fëmijët**. “Drejtësia për të mitur” fillimisht është përcaktuar në Rregullat e Pekinit si sistem që thekson mirëqenien e fëmijëve dhe proporcionalisht reagimin ndaj shkelësve dhe veprave të tyre³. Ky koncept është zhvilluar në mënyrë të konsiderueshme nga KDF, e cila kërkon që fëmijët në konflikt me ligjin të trajtohen në një mënyrë që është në përputhje me dy parime themelore.
- E para është që çdo fëmijë ka të drejtë të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe t’i respektohet plotësisht dinjiteti i tij njerëzor dhe e drejta e tij për një gjykim të drejtë.
 - E dyta është që çdo fëmijë ka të drejtë të trajtohet në një mënyrë të veçantë dhe miqësore ndaj fëmijës⁴. Kjo nënkupton, ndër të tjera, që çdo intervenim i drejtësisë për të mitur duhet të ketë për qëllim riintegrimin e fëmijës në shoqëri dhe t’i mundësohet atij⁵ që të luajë një rol konstruktiv. Me fjalë të tjera, fëmija duhet të jetë në gjendje të mësojë nga gabimet e tij dhe të merr mbështetje për të parandaluar përsëritjen e shkeljes dhe e gjithë kjo duhet të bëhet në një mënyrë të drejtë⁶.
8. Masat që ndërmerren në lidhje me fëmijët duhet të jenë në përputhje me objektivat e drejtësisë për të mitur. Ato duhet të përmirësojnë mirëqenien e fëmijës; të jenë proporcionale, miqësore ndaj fëmijës dhe të respektojnë dinjitetin njerëzor dhe të drejtën e fëmijës për një gjykim të drejtë; ato duhet t’i mundësojnë fëmijës që të riintegrohet në shoqëri. Sipas KDF, masat duhet të jenë në përputhje me parimet e përgjithshme të KDF të përfshira në nenet 2 (mos diskriminimi), 3 (interesi më i mirë i fëmijës), 6 (e drejta për të jetuar) dhe 12 (e drejta për t’u dëgjuar)⁷.

¹ Liefaard 2016.

² Liefaard 2016; Shih gjithashtu: GJEDNJ *Blokin kundër Rusisë* (2016), Kërk. nr. 47152/06, parag. 80, 170 dhe 203; GJEDNJ *M & M. kundër Kroacisë* (2015), Kërk. nr. 10161/13, parag. 102; GJEDNJ *Z.J. kundër Lituanisë* (2014), Kërk. nr. 60092/12, parag. 73 dhe 104; GJEDNJ *M.D. dhe të tjerët kundër Maltës* (2012), Kërk. nr. 64791/10, parag. 38

³ Rregulli 5 i Pekinit

⁴ Liefaard 2015

⁵ Për arsye praktike, ky manual i referohet fëmijëve dhe avokatëve në gjininë mashkullore. Edhe fëmijët dhe avokatët e gjinisë femrore duhet të konsiderohen se përfshihen në referim

⁶ Liefaard 2015

⁷ Koment i Përgjithshëm (GC) 10, para. 5.

Sipas nenit 3 të KDF, autoritetet duhet të miratojnë një qasje holistike ndaj fëmijës dhe të mendojnë përtej dispozitave të ngushta ligjore, duke marrë parasysh zhvillimin fizik, mendor, shpirtëror, moral, psikologjik dhe social të fëmijës.⁸

9. Për më tepër, neni 40(2) i KDF përmban një listë të standardeve minimale, të cilat specifikojnë të drejtën e të gjithë fëmijëve në konflikt me ligjin për trajtim dhe gjykim të drejtë. Sipas Komitetit të KDF, këto standarde përfshijnë ndalimin e drejtësisë retroaktive për të mitur, prezumimin e pafajësisë, të drejtën për pjesëmarrje efikase në procedura, të drejtën për informim të menjëhershëm dhe direkt për akuzën/akuzat, të drejtën për ndihmë juridike dhe ndihmë tjetër të përshtatshme, të drejtën për vendime pa vonesë dhe me përfshirje të prindërve, lirinë nga vet inkriminimi i detyrueshëm, “barazinë e armëve”, të drejtën për ankesë, të drejtën për ndihmë pa pagesë të një përkthyesi dhe të drejtën për respektimin e plotë të privatësisë.⁹
10. Ngjashëm, Rregullat Evropiane përfshijnë kërkesën që sanksionet apo masat të bazohen në interesat më të mira të fëmijës dhe t’i nënshtrohen parimit të proporcionalitetit, d.m.th. sanksionet apo masat do të varen nga përmasa e veprës së kryer dhe do të marrin parasysh moshën, mirëqenien fizike dhe mendore, zhvillimin, kapacitetet dhe rrethanat personale të fëmijës¹⁰Për më tepër, sipas tyre, masat duhet të përshtaten në baza individuale¹¹, të zbatohen pa vonesa të panevojshme¹² dhe të ndjekin parimin e intervenimit minimal¹³.
11. Qasja e KDF në drejtësinë për të mitur është që çdo fëmijë ka të drejtë të trajtohet në një mënyrë të veçantë dhe miqësore ndaj fëmijës. Kjo është baza e nocionit të drejtësisë miqësore për fëmijën, i cili është sqaruar në detaje në nivel evropian me miratimin e udhëzimeve. Drejtësia miqësore për fëmijën është bërë pjesë e kornizës evropiane ligjore dhe politike në lidhje me pozitën e fëmijëve në sistemet e drejtësisë penale¹⁴. Në veçanti i referohet drejtësisë që është e qasshme, e përshtatshme për moshën, e shpejtë, e kujdesshme, e përshtatur dhe e fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijës.¹⁵ Parimet e drejtësisë miqësore ndaj fëmijës vlejnë për çdo procedurë gjyqësore dhe administrative që përfshinë fëmijët (çdo person nën moshën 18 vjeçare 18, Udhëzimi II(a)).

D. Udhërrëfytesa për të Drejtat Procedurale

12. Shtetet anëtare të BE-së bashkëpunojnë nga afër në çështjet e zbatimit të ligjit në nivel ndërkufitar, kryesisht nëpërmjet mekanizmave për njohje të ndërsjellë, siç është Urdhërarresti Evropian (**EAW**). Efikasiteti i mekanizmave të tillë mbështetet në besimin e ndërsjellë mes autoriteteve gjyqësore se secila do të respektojë të drejtave e personave relevant, në veçanti siç garantohet me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (**KEDNJ**).
13. Megjithatë, bashkëpunimi është dëmtuar nga fakti se autoritetet gjyqësore, të cilave u është bërë thirrje për bashkëpunim me njëra tjetrën, në realitet nuk kanë besim të plotë në respektimin e këtyre standardeve nga ato.
14. Për të fuqizuar sistemin, BE-ja ka filluar vendosjen e standardeve minimale për rregullimin e aspekteve të caktuara të procedurës penale nëpërmjet një programi të quajtur “Udhërrëfytesa për të Drejtat Procedurale (Procedural Rights Roadmap)” (**Udhërrëfytesa**).

⁸ GC 14, para. 4.

⁹ GC 10, para. 41-67.

¹⁰ Rregulli Evropian 5

¹¹ Rregulli Evropian 6.

¹² Rregulli Evropian 9.

¹³ Rregulli Evropian 10.

¹⁴ Liefwaard 2016.

¹⁵ Udhëzimi II(c).

Përderisa këto masa e kanë origjinën në sigurimin e besimit të ndërsjellë, rezultati është një grup i direktivave që ofrojnë standardet minimale për sigurimin e besimit të ndërsjellë. Ajo që është më e rëndësishmja, këto i detyrojnë autoritetet kombëtare në të gjitha rastet, duke përfshirë ato pa elemente ndërkufitare.

Tabela 1: Përmbledhje e direktivave në bazë të udhërrëfyesit për fuqizimin e të drejtave procedurale të personave të dyshuar apo akuzuar në procedura penale

	Direktiva	Data e miratimit
1.	Direktiva 2010/64 mbi të drejtë për interpretim dhe përkthim në procedurat penale (<i>Direktiva mbi Interpretimin dhe Përkthimin</i>)	20 tetor 2010
2.	Direktiva 2012/13 mbi të drejtën për informim në procedurat penale (<i>Direktiva mbi Informimin</i>)	22 maj 2012
3.	Direktiva 2013/48 mbi të drejtën për të pasur avokat në procedurat penale dhe procedurat e urdhërarrestit evropian (<i>Direktiva mbi të Drejtën për të Pasur Avokat</i>)	22 tetor 2013
4.	Direktiva 2016/343 mbi fuqizimin e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtë për të qenë prezent në gjykim në procedurat penale (<i>Direktiva mbi Prezumimin e Pafajësisë</i>)	9 mars 2016
5.	Direktiva 2016/800 mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë të dyshuar apo akuzuar në procedura penale (<i>Direktiva mbi Fëmijët</i>)	11 maj 2016
6.	Direktiva 2016/1919 mbi ndihmën juridike për personat e dyshuar dhe akuzuar në procedura penale dhe për personat e kërkuar në procedurat e urdhërarrestit evropian (<i>Direktiva për Ndihmë Juridike</i>)	26 tetor 2016

15. Ky manual bazohet në Direktivën 2016/800 mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë të dyshuar apo akuzuar në procedura penale ([Direktiva mbi Fëmijët](#)), e cila është miratuar në vitin 2016.

II.

DIREKTIVA MBI FËMIJËT

A. Direktiva mbi Fëmijët

16. Komisioni i BE-së ka njohur që përkundër ekzistencës së standardeve të shumta ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e drejtësisë për të mitur, niveli i masave mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë në konflikt me ligjin nuk mjaftonte për të garantuar pjesëmarrjen efikase në procedura penale dhe që duhej të bëheshin përmirësime për të nxitur besimin e ndërsjellë ndërmjet shteteve anëtare¹⁶. Në veçanti, ai konsideroi që KDF ishte shumë e gjerë dhe e kufizuar në aplikueshmërinë e saj në procedurat penale dhe ka njohur që standardet e tjera ndërkombëtare dhe rajonale mbi fëmijët në konflikt me ligjin nuk kanë pasur efekt detyrues mbi shtetet anëtare. Është kuptuar që jurisprudenca e GJEDNJ për të drejtat e fëmijëve ka qenë e shpërndarë dhe ka rezultuar në interpretime të ndryshme dhe shkallë të ndryshme të zbatimit.¹⁷
17. [Direktiva mbi Fëmijët](#) është miratuar në maj të vitit 2016 dhe afati i fundit për transpozimin e saj është data 11 qershor 2019 (d.m.th. deri në këtë datë, çdo shtet anëtar duhet të ketë fuqizuar direktivën në ligjin e tyre kombëtar duke miratuar masa të duhura të zbatimit).

¹⁶Dokumenti "Impact Assessment" i Komisionit, 4.1.1.

¹⁷Po aty.

18. **Direktiva mbi Fëmijët** përcakton standardet e përbashkëta minimale mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët të cilat janë të detyrueshme në BE, dhe është hartuar për ta bërë përcaktimin efikas të të drejtave të fëmijëve të dyshuar më të drejtpërdrejtë duke u dhënë atyre fuqi detyruese në të drejtën e BE-së. Ajo bazohet në parimet e standardeve ekzistuese ndërkombëtare dhe evropiane, duke përfshirë Udhëzimet¹⁸, dhe përmban klauzolën mos-regresimit (“non-regression”) e cila thekson që mbrojtjet e parapara në direktivë nuk mund të interpretohen në nivel më të ulët se ato të KDF dhe KEDNJ. Për avokatët kjo do të thotë që KDF dhe KEDNJ, si dhe ofrimi i udhëzimit autoritativ nëpërmjet mënyrave të ndryshme, si praktika gjyqësore, komentet e përgjithshme dhe parimet e ligjit të butë, do mund të ndihmonin edhe në interpretimin e dispozitave të direktivës dhe plotësimin e boshllëqeve të mbetura.

B. Dispozitat e direktivës

19. Gjeni më poshtë një përmbledhje e dispozitave kyçe të **Direktivës mbi Fëmijët**. Këto dispozita diskutohen më në detaje në pjesën e dytë të këtij kapitulli.

Dispozita	Tema	Aspekte të rëndësishme
Neni 1	Tema lëndore	Direktiva mbulon dy kategori të fëmijëve: <ul style="list-style-type: none"> • Personat e dyshuar dhe akuzuar në procedura penale (deklamimi 17 përjashton procedurat e hartuara në mënyrë specifike për fëmijët që qojnë në masa mbrojtëse, edukative apo korrektuese); dhe • Individët që i nënshtrohen procedurave të EAW.
Neni 2	Fushëveprimi	Direktiva vlen deri në marrjen e vendimit final për rastin (që nuk përfshinë shqiptimin e ndëshkimit pas dënimit), duke përfshirë ankesat për fëmijët që janë nën moshën 18 vjeçare apo arrijnë moshën 18 vjeçare gjatë procedurave penale (megjithatë, deklamimi 12 inkurajon shtetet anëtare që të zgjasin aplikimin e masave mbrojtëse deri në moshën 21 vjeçare).
Neni 3	Përkufizimet	<ul style="list-style-type: none"> • ‘Fëmijë’ është personi nën moshën 18 vjeçare, por ekziston edhe supozimi që një individ është fëmijë nëse moshja e tij nuk dihet sigurt. • ‘Bartësi i përgjegjës së prindërore’ i referohet personit me të gjitha të drejtat dhe detyrimet në lidhje me personin apo pronën e një fëmije që i është dhënë një personi fizik apo juridik me aktgjykim, aplikim të ligjit, apo një marrëveshje që ka efekte ligjore, duke përfshirë të drejtat për kujdestari dhe të drejtat për qasje.

¹⁸ Deklamimi 7.

Neni 4	E drejta për informim	Atëherë kur fëmijët bëhen të vetëdijshëm se janë të dyshuar apo akuzuar në procedura penale, ata duhet të informohen menjëherë së pari për të drejtat e tyre sipas Direktivës mbi Informimin (2012/13/EU) dhe së dyti aspektet e përgjithshme të realizimit të procedurave. Një shpjegim i të drejtave të fëmijës duhet të jepet në gjuhë të thjeshtë dhe të qasshme dhe duhet të regjistrohet. Atëherë kur fëmijës i jepet një Letër e të Drejtave, Letra duhet të përfshijë një referim në të drejtat e tyre sipas Direktivës mbi Fëmijët.
---------------	-----------------------	--

		<p>Fëmijët duhet të informohen <i>menjëherë</i> për të drejtat e tyre sipas Direktivës mbi të Drejtat për Informim, si dhe të drejtat e veçanta që i kanë fëmijët sipas Direktivës mbi Fëmijët, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • E drejta për të informuar bartësin e përgjegjesisë prindërore; • E drejta për ndihmë nga avokati; • E drejta për privatësi; • E drejta për t'u shoqëruar nga bartësi i përgjegjesisë prindërore; dhe • E drejta për ndihmë juridike. <p><i>Në fazën më të hershme të procedurave të tyre</i>, fëmijët duhet të informohen për të drejta shtesë, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • E drejta për vlerësim individual; • E drejta për ekzaminim mjekësor; • E drejta për kufizimin e privimit nga liria dhe përdorimit të masave alternative; • E drejta për t'u shoqëruar nga bartësi i përgjegjesisë prindërore gjatë seancave dëgjimore në gjykatë; • E drejta për t'u paraqitur në gjykim; dhe • E drejta për mjete efikase juridike. <p><i>Pas privimit nga liria</i>, informacione jepen mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të drejtën për trajtim specifik gjatë privimit nga liria.
<p>Neni 5</p>	<p>E drejta për informimin e bartësit të përgjegjesisë prindërore</p>	<p>Sipas direktivës, shteteve anëtare u kërkohet të sigurojnë se bartësi i përgjegjesisë prindërore është i informuar për të drejtat e fëmijës. Sipas deklamimit 22, kjo duhet të bëhet sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe me detajet e domosdoshme për mbrojtjen e drejtësinë të procedurave dhe ushtrimin efikas të të drejtave të fëmijës.</p> <p>Një tjetër i rritur i përshtatshëm, i nominuar nga fëmija dhe i pranuar nga autoritetet kompetente, duhet të informohet nëse:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Informimi i bartësit të përgjegjesisë prindërore do të ishte në kundërshtim me interesat e fëmijës; apo • Pas përpjekjeve të arsyeshme, nuk është i mundur identifikimi apo kontaktimi i bartësit të përgjegjesisë prindërore; apo • Do të mund të rrezikonte hetimet penale (kur ka dyshim që bartësi i përgjegjesisë prindërore është bashkëfajtor në krim). • Nëse fëmija nuk cakton një të rritur të përshtatshëm, apo i rrituri i caktuar nuk është i pranueshëm për autoritetet kompetente, atëherë autoritetet kompetente duhet të caktojnë një tjetër person, duke pasur parasysh interesat më të mira të fëmijës.

<p>Neni 6</p>	<p>Asistenca nga një avokat</p>	<p>Fëmijët e dyshuar dhe të akuzuar kanë të drejtë për avokat në përputhje me Direktivën mbi të drejtën për të pasur avokat (2013/48/EU).</p> <p>Shtetet anëtare duhet të sigurojnë se fëmijët ndihmohen nga një avokat për t’iu lejuar atyre që të ushtrojnë të drejtat e tyre në mënyrë efikase.</p> <p>Fëmijët ndihmohen nga një avokat pa vonesë pasi të kuptojnë se janë të dyshuar apo akuzuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Para se të merren në pyetje nga policia apo autoriteti tjetër përgjegjës për zbatimin e ligjit apo autoriteti gjyqësor; apo • Në fillim të veprimeve për hetim apo mbledhjen e dëshmimeve (këto përfshijnë, së paku, paradat e identifikimit, konfrontimet dhe rikrijimin e skenës së krimimit); apo • Pas privimit të lirisë; apo • Kur thirren të paraqiten në gjykatë, në një kohë adekuate para se të paraqiten në gjykatë. <p>Kjo ndihmë përfshinë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të drejtën për t’u takuar dhe komunikuar privatisht, duket përfshirë para marrjes në pyetje; • Për t’u asistuar nga një avokat gjatë marrjes në pyetje; dhe • Për t’u asistuar gjatë veprimeve hetuese. <p>Shtetet anëtare mund të derogojnë nga disa dispozitat e përmendura më lartë, por si do që të jetë rasti, fëmijët kanë të drejtë për ndihmë nga një avokat:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kur ata sjellën para gjykatës apo gjykatësit për vendosur mbi paraburgimin; dhe/ose • Gjatë paraburgimit. <p>Shtetet anëtare duhet të respektojnë të drejtën e konfidencialitetit dhe e drejta e konfidencialitetit është e pa derogueshme.</p>
----------------------	---------------------------------	--

Neni 7	E drejta për vlerësim individual	<p>Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që merren parasysh nevoja specifike të fëmijës, si mbrojtja, edukimi, trajnimi dhe integrimi. Për ta bërë këtë, duhet të bëhet një vlerësim individual nga personeli i kualifikuar, duke ndjekur, për aq sa është e mundur, një qasje multi-disiplinare për të vlerësuar personalitetin dhe pjekurinë e fëmijës dhe historikun e tij ekonomik, social dhe familjar, si dhe cenueshmëritë (si paaftësitë intelektuale dhe vështirësitë në komunikim). Vlerësimet duhet të kryhen në fazën më të hershme të mundshme dhe me përfshirjen nga afër të fëmijës.</p> <p>Vlerësimi mund të përcaktojë dhe theksojë informacionet relevante që do të mund të ishin të dobishme në përcaktimin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • nëse një masë specifike është në përfitim të fëmijës; • e përshtatshmërisë dhe efikasitetit të masave parandaluese; dhe • Vendimet në procedurat penale, përfshirë dënimin.
---------------	----------------------------------	--

Neni 8	E drejta për ekzaminim mjekësor	Fëmijët e privuar nga liria kanë të drejtë për ekzaminim mjekësor pa vonesë të panevojshme me qëllim të vlerësimit të gjendjes së tyre mendore dhe fizike. Ky ekzaminim duhet të kryhet nga një profesionist dhe duhet të jetë sa më jo invaziv që të jetë e mundur. Rezultatet e ekzaminimit mjekësor duhet të merren parasysh kur përcaktohet kapaciteti i fëmijës për t'iu nënshtruar marrjes në pyetje dhe veprimeve apo masave tjera hetuese që duhet të merren ndaj fëmijës. Kërkesa për ekzaminim mjekësor mund të bëhet nga fëmija, bartësi i përgjegjësisë prindërore apo avokati i fëmijës.
Neni 9	Regjistrimi audio vizual i procesit të marrjes në pyetje	Sipas direktivës, marrja në pyetje e fëmijës i nënshtrohet regjistrimit audio vizual kur një gjë e tillë është e përshtatshme në rrethanat e rastit, duke marrë parasysh rrethanat, si prania e avokatit apo nëse fëmija është i privuar nga liria, gjithmonë duke pasur në mendje interesat më të mira të fëmijës.
Neni 10	Kufizimi i privimit nga liria	Privimi i lirisë duhet të përdoret si masa e fundit dhe për kohën më të shkurtër të mundshme. Vendimi për privimin e një fëmije nga liria duhet të jetë i arsyeshëm dhe t'iu nënshtrohet shqyrtimit gjyqësorë, në intervale të rregullta, me kërkesën e fëmijës, avokatit të fëmijës apo të një autoriteti gjyqësorë që nuk është gjykatë. Vendimet duhet të bëhen pa vonesë të panevojshme.
Neni 11	Masat alternative	Kur është e përshtatshme, duhet të vihen në dispozicion masa tjera alternative përveç paraburgimit.
Neni 12	Trajtimi specifik në rast të privimit nga liria	Fëmijët duhet të mbahen ndaras nga të rriturit, përveç nëse kjo nuk është në interesin më të mirë të fëmijës. Në rast të ndalimit nga policia, shtetet anëtare mund të devijojnë nga kjo atëherë kur rrethana të jashtëzakonshme e bëjnë ndarjen të pamundur, apo kur është në interesin më të mirë të fëmijës. Atëherë kur fëmijët ndalohen në mbajtje, duhet të merren masat të përshtatshme për të: <ul style="list-style-type: none"> • siguruar dhe mbrojtur shëndetin dhe zhvillimin mendor dhe fizik; • siguruar të drejtën për arsim dhe trajnim, duke përfshirë edhe kur kanë aftësi të kufizuara; • siguruar ushtrimin efikas dhe të rregullt të të drejtës për jetë familjare (deklamimi 51); • siguruar qasjen në programe që nxitin zhvillimin dhe riintegrimin në shoqëri; • siguruar respektimin e lirisë së fesë apo besimit (deklamimi 52); dhe • lejuar fëmijën që të takohet me bartësin e përgjegjësisë prindërore së më parë që është e mundur, për aq sa kjo është në përputhje me kërkesat hetimore dhe operative.

Neni 13	Trajtimi në kohë dhe i kujdesshëm i rasteve	Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin të gjitha masat e duhura për të siguruar se procedurat penale trajtohen si urgjencë, me kujdesin e duhur, dhe se fëmija trajtohet në një mënyrë që mbron dinjitetin e tyre dhe është e përshtatshme për moshën, pjekurinë dhe nivelin e të kuptuarit (duke marrë parasysh nevojat e veçanta, duke përfshirë vështirësitë në komunikim).
Neni 14	E drejta për mbrojtjen e privatësisë	Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që mbrohet e drejta e fëmijës për privatësi. Seancat dëgjimore në gjykatë që përfshijnë fëmijët duhet të mbahen në mungesë të publikut, apo gjykatat dhe gjykatësit mund të vendosin që të mbajnë seancat e tilla dëgjimore në mungesë të publikut. Shtetet anëtare duhet gjithashtu të inkurajojnë median që të zbatojë masa vetë-rregullative për të arritur këtë objektiv.
Neni 15	E drejta për t'u shoqëruar nga bartësi i përgjegjesisë prindërore gjatë procedurave	Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që fëmijët kanë të drejtë të shoqërohen nga bartësi i përgjegjesisë prindërore gjatë procedurave gjyqësore. Një i rrituri i përshtatshëm mund të caktohet në përputhje me rrethanat dhe me metodat e përcaktuara në nenin 5. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që bartësi i përgjegjesisë prindërore apo ndonjë i rritur tjetër i përshtatshëm është i pranishëm në procedura, përveçse në seancat dëgjimore në gjykatë, nëse kjo është në interesin më të mirë të fëmijës dhe prania e një personi të tillë nuk cenon procedurat penale.
Neni 16	E drejta për t'u paraqitur personalisht dhe për të marrë pjesë në gjykimin e tyre	Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që fëmijët kanë të drejtë të jenë prezent në gjykim dhe të ndërmarrin të gjitha masat e domosdoshme për t'i mundësuar fëmijës që të marrë pjesë në mënyrë efikase, duke përfshirë mundësinë për t'u dëgjuar dhe për shprehur pikëpamjet e tij (sipas deklamimit 60, shtetet anëtare duhet gjithashtu të ndërmarrin masat e përshtatshme për të siguruar pjesëmarrjen e fëmijës në gjykim, duke përfshirë dërgimin e thirrjeve tek bartësi i përgjegjesisë prindërore). Fëmijët që nuk janë të pranishëm në gjykim kanë të drejtë për gjykim të ri apo ndonjë mjet tjetër juridik.
Neni 17	Procedurat e urdhërarres tit evropian	Direktiva mbron të drejtat e caktuara të fëmijëve që i nënshtrohen procedurave të EAW. Këto të drejta përfshijnë: <ul style="list-style-type: none"> • Të drejtën për ndihmë juridike; • Të drejtën për ta informuar bartësin e përgjegjesisë prindërore; • Të drejtën për ekzaminim mjekësor; • Të drejtën për kufizim të privimit nga liria; dhe • Të drejtën për t'u shoqëruar nga bartësi i përgjegjesisë prindërore në procedura penale.
Neni 18	E drejta për ndihmë juridike	Ndihma juridike mund të vihet në dispozicion kur është e domosdoshme për të garantuar ushtrimin efikas të të drejtës për t'u

		asistuar nga një avokat.
--	--	--------------------------

Neni 19	Mjetet juridike	Fëmijët kanë të drejtë për mjete efikase juridike sipas ligjit kombëtar në rast të shkeljes së të drejtave të tyre të përcaktuara në direktivë.
Neni 20	Trajnimi	Shtetet anëtare duhet të ndërmarrin masa të përshtatshme për të siguruar që gjykatësit dhe prokurorët kanë kompetencë specifike apo kanë qasje efikase në trajnim specifik. Ato gjithashtu duhet të ndërmarrin masa të përshtatshme për të promovuar trajnimin për avokatët që punojnë me fëmijët me shërbime mbështetëse dhe të rivendosjes së drejtësisë për të marrë trajnim adekuat.
Neni 23	Mos- regresimi	Direktiva nuk duhet në asnjë mënyrë të interpretohet si regresion nga Karta, KEDNJ, apo e drejta ndërkombëtare, përfshirë KDF e OKB-së.

III.

PARIMET KYÇE NË DIREKTIVËN MBI FËMIJËT

20. **Direktiva mbi Fëmijët** është e rëndësishme në masë të madhe pasi që specifikon dhe parasheh zbatueshmërinë e drejtpërdrejt për disa nga konceptet themelore të drejtësisë për të mitur të zhvilluar nën standarde tjera ndërkombëtare dhe evropiane. Forma të cilën e merr secila në direktivë tani shqyrtohet, duke adresuar secilën nga mbrojtjet kryesore që parasheh direktiva dhe duke i vendosur ato në kontekst më të gjerët të të drejtës ndërkombëtare dhe evropiane (në veçanti KDF). Këtu shqyrtohen fushat e paqartësisë në dispozitat e direktivës dhe implikimet e tyre në praktikë shqyrtohen më nga afër në seksionin IV.

A. Fushëveprimi i drejtësisë për të mitur

21. Sipas **Direktivës mbi Fëmijët**, 'fëmijë' është çdokush nën moshën 18 vjeçare¹⁹ dhe kur nuk dihet moshja sigurt, duhet të supozohet që i akuzuari është fëmijë²⁰. Në direktivë gjithashtu parashihet në mënyrë eksplicite se në rast se fëmija arrin moshën 18 vjeçare gjatë rrjedhës së procedurave penale, do të vlejë për ato procedura²¹. Direktiva gjithashtu vlen kurdo që fëmija është i privuar nga liria, pavarësisht fazës së procedurave penale²².

22. Direktiva është më rigorozë se sa KDF, e cila vlen për të gjithë personat nën moshën 18 vjeçare, përveç nëse me ligjin kombëtar për fëmijën pjekuria arrihet më herët (neni 1 i KDF). Me Rregullat e Pekinit dhe Rregullat e Havanës, ligjvënësit kanë pak fleksibilitet në përcaktimin se cilët fëmijë marrin mbrojtje të veçantë juridike²³. Megjithatë, niveli i mbulimit në direktivë nuk është sa në Rregullin Evropian, sipas të cilit shtetet inkurajohen të shtrijnë fushëveprimin e drejtësisë për të mitur tek "shkelësit madhor të ri," që nënkupton personat ndërmjet moshës 18 dhe 21 vjeçare që pretendohet se kanë apo kanë kryer një vepër.²⁴

23. **Direktiva mbi Fëmijët** nuk vlen për rastet që përfshijnë kundërvajtjet (me kusht që paraburgimi nuk mund të vendoset si sanksion dhe shqiptimi i ndonjë sanksioni mund të apelohej në gjykatë)²⁵. Kjo mund të krijojë pasiguri duke pasur parasysh që "kundërvajtjet" nuk janë të përcaktuara qartë, duke lënë hapësirë për shtetet anëtare të BE-së që të përjashtojnë vepra të caktuara nga **fushëveprimi i Direktivës**.

24. Avokatët duhet të jenë të vetëdijshëm se edhe nëse një vepër klasifikohet si kundërvajtje sipas ligjit kombëtar, mund të karakterizohet si aktakuzë penale në përputhje me nenin 6 të KEDNJ. Sipas KEDNJ, aktakuza penale ka kuptim autonom. GJEDNJ vendos përfundimisht se çka kualifikohet si kallëzim penal dhe për cilat vepra nevojitet gjykim i drejtë (duke përfshirë të drejtën për ndihmë juridike) në përputhje me nenin 6 të KEDNJ.²⁶

¹⁹ Neni 3(1) i Direktivës mbi Fëmijët

²⁰ Neni 3(1) i Direktivës mbi Fëmijët

²¹ Neni 2(3) i Direktivës mbi Fëmijët

²² Neni 2(6) i Direktivës mbi Fëmijët.

²³ Sipas Rregullit të Pekinit, 'i mitur' është fëmijë apo personi i ri i cili, sipas sistemit përkatës ligjor, mund të trajtohet për një vepër në një mënyrë që është e ndryshme nga ajo për një të rritur (Rregulli 2.2 (a) Rregullat e Pekinit). Në fakt, sipas Rregullave të Pekinit, ligjvënësi vendor ka liri veprimi që të përcaktojë "të miturin" në lidhje me sistemin e tyre të drejtësisë për të mitur. Në të kundërtën, sipas Rregullave të Havanës, "i mitur" është çdo person nën moshën 18 vjeçare. Rregullat e Havanës gjithashtu përcaktojnë që kufiri i moshës nën 18 vjeç lejohet për ta privuar një fëmijë nga liria e tij apo saj duhet të përcaktohet me ligj (Rregulli 11(a) i Rregullave të Havanës

²⁴ Rregulli Evropian 17 dhe 21.2

²⁵ Direktivat tjera të Udhërrëfyesit përmbajnë klauzola të ngjashme. Nuk janë identike me ato në Direktivën mbi Fëmijët

²⁶ KEDNJ *Engel kundër Holandës* (1976), Kërk. nr. 5100/71; 5101/71; 5102/71; 5354/72; 5370/72

B. Interesat më të mira të fëmijës

25. Është e qartë se interesat më të mirë të fëmijës janë koncepti kryesor në **Direktivën e Fëmijëve**, e cila thekson se Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që interesat më të mirë të fëmijës janë gjithmonë konsideratë primare (theksim i shtuar).²⁷ Koncepti i interesave më të mirë të fëmijës është fleksibil dhe i adaptueshëm. Ai duhet të rregullohet dhe të definohet në baza individuale.²⁸ Shprehja "konsideratë primare" nënkupton se interesat më të mirë të fëmijës mund të mos merren në konsideratë në të njëjtin nivel si gjitha konsideratat tjera.²⁹ Ky qëndrim i fortë arsyetohet nga situata e veçantë e fëmijës: "varësia, maturiteti, statusi ligjor dhe shpesh mungesa e zërit të tyre."³⁰ Direktiva po ashtu parasheh shprehimisht që interesat më të mirë të fëmijës duhet të jenë faktor përcaktues në një gamë të gjerë vendimesh,³¹ duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me qasjen tek një avokat, rolin e prindërve dhe të rriturve të tjerë të përshtatshëm si dhe paraburgimin.
26. Kjo qasje pasqyron nenin 3(1) të KDF, i cili i jep fëmijës të drejtën që interesat e vetë më të mirë të vlerësohen dhe të merren parasysh si konsideratë primare në të gjitha veprimet ose vendimet në lidhje me të, si në sferën publike, ashtu edhe në atë private.³² Kjo nënkupton se avokatët kanë detyrën e rëndësishme që të sigurojnë se interesat më të mirë të fëmijës janë duke u marrë parasysh gjatë procedurave penale.
27. Komiteti i KDF-së theksoi se interesat më të mirë të fëmijës janë një koncept i trefishtë që operon në mënyra të ndryshme si:
- Një e drejtë thelbësore, që kërkon konsiderimin e interesave të fëmijës mbi faktorë të tjerë kurdo që merret një vendim në lidhje me fëmijën, edhe nëse ka interesa të tjera. Fëmijët shpesh nuk janë në gjendje të avokojnë interesat e tyre vetanake, kështu që autoritetet kanë detyrimin ligjor që të jenë të vetëdijshëm për interesat e tyre dhe t'i trajtojnë ata si të një rëndësie të madhe;³³
 - Një parim ligjor për interpretimin, me ç'rast nëse një dispozitë është e paqartë, duhet të zgjidhet interpretimi që në mënyrën më efektive i shërben interesit më të mirë të fëmijës; dhe
 - Një e drejtë procedurale, ku çdo vendim që prek një fëmijë duhet të merret përmes një procesi që përfshin edhe një vlerësim të ndikimit të mundshëm tek fëmija. Shtetet duhet të konsiderojnë që fëmijët dallojnë me të rriturit për nga zhvillimi dhe nevojat e tyre. Dallimet e tilla përbëjnë bazën për fajësinë më të vogël të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe nënkuptojnë që objektivat tradicionale të drejtësisë penale, siç është parandalimi dhe ndëshkimi, duhet t'i hapin rrugën objektivave të rehabilitimit dhe drejtësisë restauruese me rastin e trajtimit të fëmijëve si merren me shkelësit e ligjit.³⁴

Përcaktimi i interesave më të mira të fëmijës

²⁷ KEDNJ, Paragrafi 8.

²⁸ GC 14, para. 32.

²⁹ GC 14, para. 37.

³⁰ GC 14, para. 37.

³¹ Vini re se referencat në Direktivën e Fëmijëve për interesat më të mirë të fëmijës mund të konsiderohen të tepërta, pasi Neni 24 (2) i Kartës së të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian kërkon që Shtetet Anëtare të BE-së të marrin në konsideratë "interesat më të mira të fëmijës" si një "konsideratë primare" në "të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët" (theksimi i shtuar).

³² GC 14, para. 1. Shih gjithashtu GC 10, paragrafi 5, sipas të cilit çdo veprim apo vendim i drejtësisë për të mitur duhet të merret dhe zbatohet në përputhje me këtë të drejtë

³³ GC 14, para. 37.

³⁴ GC 10, para. 10.

28. Interesi më i mirë i secilit fëmijë përkatës duhet të përcaktohet rast pas rasti, dhe mund të ndryshojë me kalimin e kohës.³⁵ Kjo nënkupton se avokatët dhe akterët tjerë në sistemin e drejtësisë për të mitur kanë një detyrë të vazhdueshme që të përcaktojnë interesat më të mirë të fëmijës. Avokatët nuk duhet të priorizojnë gjykimet e tyre intuitive për të përcaktuar interesat më të mirë të fëmijës, dhe duhet po ashtu të jenë të vëmendshëm në pranimin e vlerësimeve të autoriteteve për interesin më të mirë të fëmijës. Ata duhet të përcaktojnë interesat më të mirë të klientëve të tyre fëmijë duke i dëgjuar pikëpamjet e tyre dhe duke realizuar një vlerësim holistik të rrethanave të tyre.
29. Fëmijët kanë të drejtë të shprehin pikëpamjet e tyre, të cilave duhet dhënë rëndësinë e duhur nga ana e autoriteteve në të gjitha çështjet që i prekin ata,³⁶ dhe kjo nënkupton që ata luajnë një rol të rëndësishëm në përcaktimin e asaj që është në interesin e tyre më të mirë. Avokatët duhet t'i konsiderojnë fëmijët si klientë të plotë, dhe të sigurojnë që pikëpamjet e tyre të dëgjohen.³⁷ Megjithatë, avokatët duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë shkallën në të cilën klientët e tyre i kuptojnë implikimet ligjore të vendimeve të tyre,³⁸ prandaj pesha që i jepet pikëpamjeve të fëmijëve në përcaktimin e interesave të tyre më të mirë duhet të vlerësohet në baza rast-pas-rasti. Sa më shumë që fëmija din dhe kupton, aq më shumë avokati duhet të udhëhiqet nga pikëpamjet e fëmijës në përcaktimin e interesave të tyre më të mira.³⁹
30. Për të vlerësuar interesat më të mirë të fëmijës, avokatët duhet të njoftohen me gjendjen fizike, mendore, shpirtërore, morale, psikologjike dhe shoqërore të fëmijës.⁴⁰ Ata duhet të marrin një pikëpamje holistike të zhvillimit të fëmijës, dhe kjo nënkupton se ata zakonisht duhet të krijojnë raporte të mira me fëmijën për të marrë njohuri të dorës së parë mbi problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen ata (madje edhe përtej kufijve të çështjes ligjore).⁴¹ Kjo gjithashtu do të thotë se avokatët mund të duhet të konsultohen me punëtorët socialë, shkollën e fëmijës, prindërit dhe personat e tjerë relevantë, të cilët mund t'i japin avokatit një analizë gjithëpërfshirëse të rrethanave të fëmijës. Nevojitet një qasje shumë-disiplinore dhe ndër-sektoriale për të siguruar një qasje holistike dhe vazhdimësinë e kujdesit për fëmijët.⁴²
31. Për avokatët mund të jetë e dobishme të kenë njohuri mbi trurin e adoleshentëve, shkencën zhvillimore, varfërinë, sëmundjet mendore, abuzimin, alkoolizmin, disfunksionet familjare, etj.,⁴³ për të informuar përcaktimin e tyre mbi interesat më të mirë të fëmijës. Ata dhe autoritetet duhet të marrin parasysh që fëmijët dallojnë me të rriturit për nga zhvillimi i tyre fizik dhe psikologjik, si dhe për nga nevojat e tyre emocionale dhe edukative, prandaj edhe këto dallime përbëjnë bazën për fajësi më të vogël të fëmijëve në konflikt me ligjin.

Interesat më të mira të fëmijës si një e drejtë procedurale

32. Është e rëndësishme që avokatët të sigurojnë qasjen e fëmijës në procedurat që mundësojnë vlerësimin e interesave të tyre më të mira. **Direktiva për Fëmijët** përcakton që Shtetet Anëtare kanë për detyrë të sigurojnë që nevojat specifike të fëmijës (në aspektin e mbrojtjes, arsimit, trajnimit, integritimit social etj.) të merren parasysh,⁴⁴ dhe kërkon që të kryhet një vlerësim individual për atë qëllim. Rezultatet e vlerësimit mund të jenë të dobishme në përcaktimin nëse ndonjë masë specifike

³⁵ GC 14, para. 32.

³⁶ Neni 12 KDF dhe GC 14, para. 43.

³⁷ Udhëzuesi 40.

³⁸ Neni 5 KDF (në lidhje me kapacitetet zhvilluese të fëmijës) luan një rol këtu.

³⁹ Beijer & Liefwaard 2011 dhe GC 14, para. 44.

⁴⁰ Udhëzuesit 16 dhe 17.

⁴¹ GC 14, para. 14; Shih gjithashtu kapitullin 3 mbi komunikimin dhe informacionin.

⁴² Rregulli Evropian 15.

⁴³ Polansky, 2015, 4.

⁴⁴ Neni 7(1) Direktiva për Fëmijët.

do të ishte e dobishme për fëmijën dhe përshtatshmërinë e masave parandaluese, si dhe në dënim.

33. Neni 8 i **Direktivës së Fëmijëve** krijon një të drejtë të veçantë për një ekzaminim mjekësor për të vlerësuar gjendjen mendore dhe fizike të fëmijës. Kjo duhet të merret parasysh gjatë përcaktimit të kapacitetit të çdo fëmije që i nënshtrohet marrjes në pyetje, akteve të tjera hetimore ose masave të tjera të marra ndaj fëmijës. Kërkesa për ekzaminim mjekësor mund të bëhet nga fëmija, mbajtësi i përgjegjësishë prindërore ose avokati i fëmijës.

C. Pjesëmarrja efektive

34. Pjesëmarrja efektive është identifikuar nga GJEDNJ si një parim udhëzues në drejtësinë për të mitur dhe gjithashtu nga Komiteti i KDF si kusht për një gjykim të drejtë.⁴⁵ Është e qartë nga vlerësimi i ndikimit nga Komisioni i BE-së për **Direktivën e Fëmijëve** që lehtësimi i pjesëmarrjes efektive të fëmijëve ishte menduar si një objektivi primar i Direktivës. Komisioni miratoi përkufizimin e GJEDNJ-së për pjesëmarrjen efektive në rastin e *S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar* si të tillë që njeh se:

*“në rastin e një fëmije, është thelbësore që ai/ajo të trajtohet në një mënyrë që merr plotësisht parasysh moshën e tij/saj, nivelin e pjekurisë dhe kapacitetet intelektuale dhe emocionale, dhe që ndërmerren hapa për të promovuar aftësinë e tij/saj për të kuptuar dhe për të marrë pjesë në procedura, duke përfshirë kryerjen e seancës në mënyrë të tillë që të ulë sa më shumë që është e mundur ndjenjat e tyre të frikësimit dhe ndalimit”.*⁴⁶

35. Kjo e bën të qartë se pjesëmarrja efektive nënkupton jo vetëm që një fëmijë duhet të dëgjohej, por edhe se shtetet duhet të sigurojnë që fëmija ka një të kuptuar të gjerë të natyrës së hetimit dhe të asaj se çfarë rrezikon.⁴⁷

Pjesëmarrja efektive: E drejta për t'u dëgjuar

36. E drejta për t'u dëgjuar është parim i përcaktuar në nenin 12 të KDF-së, dhe Neni 16 i **Direktivës së Fëmijëve** i jep fuqi kësaj të drejtë duke konfirmuar se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të paraqiten personalisht në gjykim dhe të marrin pjesë. Kjo e drejtë duhet të respektohet në të gjitha fazat e procesit, duke filluar me fazën e procedurës paraprake.⁴⁸
37. Megjithatë, e drejta për t'u dëgjuar kërkon që shtetet të bëjnë më shumë sesa thjesht të ofrojnë mundësi për fëmijën që të flasë. Fëmijët nuk e shprehin veten në mënyrën e njëjtë si të rriturit, dhe ka gjasa të jenë më pak të familjarizuar apo komod me gjuhën, formalitetin dhe atmosferën e një gjykimi (ose mjedisin frikësues të një interviste policore). Prandaj, për t'u siguruar që atyre u ofrohet një mundësi reale për të shprehur pikëpamjet e tyre lirshëm kërkon dhënien e një mbështetjeje të veçantë,⁴⁹ dhe pikëpamjeve të tyre duhet kushtohet rëndësia e duhur në përputhje me moshën dhe pjekurinë e fëmijës.⁵⁰
38. Kurdo që fëmija është duke u dëgjuar nga autoritetet (përfshirë edhe në gjykatë) dhe avokati është i pranishëm, avokati duhet të sigurojë një atmosferë që i mundëson fëmijës të shprehet lirshëm.⁵¹

⁴⁵ GC 10, para. 46.

⁴⁶ Vlerësimi i Ndikimit nga Komisioni.

⁴⁷ GJEDNJ *S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2004), apl. nr. 60958/00 para. 29.

⁴⁸ GC 10, para. 44.

⁴⁹ Udhëzuesit 54-63.

⁵⁰ Neni 12 (1) KDF, GJEDNJ *T. kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1999), apl. nr. 24724/94.

⁵¹ Rregulla e Pekinit 14.2.

Procedurat duhet përgjithësisht të kryhen në një mënyrë miqësore për fëmijën, siç kërkohet nga Udhëzuesi,⁵² dhe avokatët duhet të jenë të përgatitur që të ndërhyjnë kur kjo nuk respektohet, për shembull, kur zyrtarët policorë janë armiqësor ndaj fëmijës ose procedurat gjyqësore zgjasin shumë dhe nuk ofrohen pushime.

39. Fëmijët duhet gjithashtu të konsultohen mbi mënyrën në të cilën ata duan të dëgohen.⁵³ Një fëmijë nuk duhet të përjashtohet nga të dëgjuarit vetëm në bazë të moshës. Kurdo që një fëmijë merr iniciativën për t'u dëgjuar në një rast që e prek atë, gjykatësi nuk duhet (përveç nëse është në interesin më të mirë të fëmijës) të refuzojë dëgjimin e fëmijës dhe duhet t'i dëgjojë pikëpamjet dhe opinionet e tij/saj për çështjet që ndërlidhen me të në rast.⁵⁴ Avokatët duhet t'i ofrojnë fëmijës të gjitha informacionet dhe shpjegimet e nevojshme në lidhje me pasojat e mundshme të pikëpamjeve dhe/ose opinioneve të fëmijës.⁵⁵
40. Komiteti i KDF thekson se fëmija ka të drejtë të dëgjohej drejtpërdrejtë dhe jo vetëm përmes përfaqësimit të tij, nëse kjo është në interesin e tij më të mirë.⁵⁶ Në këtë pikë, duhet të përsëritet rëndësia e qasjes shumë-disiplinore drejt vlerësimit të interesave më të mirë të fëmijës. Me ndihmën e profesionistëve tjerë (punëtorëve socialë ose ndoshta mësuesve të shkollave), maturiteti i fëmijës mund të vlerësohet dhe pikëpamjeve të tij duhet t'u kushtohet rëndësia e duhur. Në këtë fazë duhet të identifikohet çdo vështirësi në komunikim që do të mund të pengonte pjesëmarrjen kuptimplotë.⁵⁷
41. E drejta për t'u dëgjuar vlen edhe për periudhën e zbatimit të çdo mase të shqiptuar, siç është privimi nga liria. Me përjashtim të rasteve të periudhave shumë të shkurtra të heqjes së lirisë, duhet të zhvillohet një plan i përgjithshëm edukativ i përshtatur për karakteristikat individuale të fëmijës. Pikëpamjet e fëmijës duhet të merren parasysh gjatë gjithë kohës në të cilën ai është nën mbikëqyrjen ose kontrollin e autoriteteve.⁵⁸

Pjesëmarrja efektive: E drejta për informim

42. E drejta për informim është e paraparë me nenin 4 të **Direktivës së Fëmijëve**, dhe konstaton se fëmijës duhet t'i ofrohet një shpjegim i të drejtave të tij/saj në një gjuhë të thjeshtë dhe të qasshme. GJEDNJ pranoi në *S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar* se të akuzuarit i duhet të kuptoj gjerësisht natyrën e procesit të gjyqimit dhe asaj që rrezikon, përfshirë edhe peshën e çdo ndëshkimi që mund të shqiptohet, në mënyrë që individit të merr pjesë në mënyrë efektive në procedurë. Megjithatë, duhet të përmendet që as S.C. e as Direktiva nuk kërkojnë që fëmijët të kuptojnë çdo aspekt të gjyqimit.
43. Qëndrimi i miratuar nga Direktiva dhe GJEDNJ pasqyron atë të KDF, ku vetëdijesimi i fëmijëve mbi të drejtat e tyre është thelbësor për të siguruar drejtësinë e të miturve.⁵⁹ Të drejtat mund të ushtrohen në mënyrë efektive vetëm nëse ata janë të vetëdijshëm për to dhe kanë mënyra të kërkimit të një mjeti juridik kundër shkeljeve të mundshme të këtyre të drejtave. Mungesa e njohurive mbi këto të drejta dhe akuza kundër tyre mund po ashtu të parandalojnë fëmijët nga shprehja e pikëpamjeve të tyre në mënyrë efektive, duke mos lejuar që interesat e tyre më të mira të trajtohen me rëndësinë e

⁵² Udhëzuesi 54.

⁵³ Udhëzuesi 44.

⁵⁴ Udhëzuesi 47.

⁵⁵ Udhëzuesi 41.

⁵⁶ GC 10, para. 44.

⁵⁷ Udhëzuesi III (A)(1).

⁵⁸ Rregullat evropiane 62.6 (c) dhe (d).

⁵⁹ Neni 12 KDF.

duhur.

44. Komiteti i KDF ka treguar se fëmija duhet po ashtu të informohet për procesin e të drejtave për të miturit në tërësi dhe për masat e mundshme që mund të merren.⁶⁰ Neni 40(2)(b)(ii) i KDF parasheh veçanërisht që një fëmijë që dyshohet se ka kryer një vepër ka të drejtë të informohet për akuzat kundër tij “menjëherë dhe drejtpërsëdrejti” (d.m.th. kur prokurori ose gjykatësi fillimisht merr hapa procedural kundër një fëmije ose kur autoritetet vendosin të merren me një çështje pa procedura gjyqësore).
45. Është fëmija ai që duhet të kuptojë akuzat kundër tij. Autoritetet nuk duhet t'ua lënë këtë prindërve, kujdestarëve ligjorë ose avokatit të fëmijës.⁶¹ Kjo nënkupton se informacionet dhe shpjegimet duhet t'i komunikohen fëmijës direkt dhe jo përmes prindërve ose avokatit.⁶² Neni 5 i **Direktivës së Fëmijëve** krijon edhe një të drejtë të veçantë për fëmijën që të ketë të drejtën e mbajtësit të përgjegjësishëm prindërorë (ose një personi tjetër të përshtatshëm) për të drejtat e fëmijës sa më shpejt që të jetë e mundur dhe me detaje të mjaftueshme për të mbrojtur paanësinë e procedurës.
46. Udhëzuesit e shpjegojnë të drejtën për informim më në detaje. Ata kërkojnë dhënien e informacioneve që mund të mos jenë të lidhura drejtpërdrejt me procedurat ligjore, por që prapë mund të jenë të nevojshme për ri-integrimin e fëmijës në shoqëri, siç është informacioni lidhur me sistemet përkatëse të mbështetjes. Sipas Udhëzuesve, fëmijët që nga kontakti i tyre i parë me sistemin e drejtësisë ose ndonjë autoriteti tjetër (siç është policia) të jenë të informuar në mënyrë adekuate për: (a) të drejtat e tyre; (b) sistemin dhe procedurat e përfshira; (c) mekanizmat përkatës të mbështetjes; (d) pasojat e procedurave gjyqësore ose jo-gjyqësore; (e) akuzat; (f) kohën dhe vendin e procedurave gjyqësore, kur është relevante; (g) progresin e përgjithshëm dhe rezultatet e procedurave ose intervenimit; (h) disponueshmërinë e masave mbrojtëse; (i) mekanizmat për shqyrtimin e vendimeve; (j) mundësitë për të marrë dëmshpërblim nga shkelësi ose shteti; (k) disponueshmërinë e shërbimeve (si ato shëndetësore, psikologjike, sociale, të interpretimit dhe përkthimit dhe të tjera) dhe mjetet e qasjes në shërbime të tilla (me mbështetje financiare); dhe (l) çdo marrëveshje të veçantë nëse banojnë në një shtet tjetër.⁶³

D. E drejta për ndihmë juridike

47. E drejta e qasjes në avokat është një e drejtë vendimtare për gjykim të drejtë, duke pasur parasysh rolin e rëndësishëm që ndihma juridike mund të luajë për të siguruar mundësinë e gëzimit të drejtave të tjera. Kjo e drejtë është veçanërisht e rëndësishme për fëmijët, mosha dhe përvoja e të cilëve mund të përbëjnë pengesa shtesë që komprometojnë aftësinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë efektive në procedurat e tyre penale.
48. Për këtë qëllim, **Direktiva e Fëmijëve** parasheh të drejtën e ndihmës nga një avokat, përveç të drejtës për qasje tek një avokat që u jepet të gjithë të dyshuarve dhe personave të akuzuar në Direktivën për Qasje në Avokat.⁶⁴ Kjo nënkupton se Shtetet Anëtare kanë detyrimin pozitiv që të sigurohen se fëmija ndihmohet nga një avokat, pavarësisht faktit se a e ka kërkuar fëmija të drejtën e

⁶⁰ GC 10, para. 44.

⁶¹ GC 10, para. 48.

⁶² Liefgaard et al., 2016.

⁶³ Udhëzuesi IV(A)1(a-l).

⁶⁴ Direktiva e Fëmijëve i ka dhënë fuqi nenit 40(2)(b)(ii) të KDF, e drejta për ndihmë juridike ose '*ndihmë tjetër të përshtatshme*' në përgatitjen e mbrojtjes së tyre, dhe nenit 37(d), e drejta e qasjes tek ndihma ligjore për fëmijët që u është hequr liria. Megjithatë, Direktiva e Fëmijëve ka shkuar përtej këtyre neneve në kërkimin e ofrimit të ndihmës reale nga një avokat në rrethana të caktuara, dhe jo vetëm të drejtën për ndihmë juridike (ose ndihmë tjetër të përshtatshme).

qasjes në avokat.⁶⁵ Fushëveprimi i së drejtës për ndihmë juridike është diskutuar më në detaje në Kapitullin 4 të këtij manuali, por duhet theksuar në këtë fazë se dispozitat në lidhje me të drejtën për ndihmë juridike pasqyrojnë në masë të madhe dispozitat në Direktivën për Qasje në Avokat. Shtetet Anëtare kërkohet të sigurojnë që fëmijët ndihmohen nga një avokat pa vonesa të panevojshme nga momenti që vihen në dijeni se janë persona të dyshuar ose të kërkuar (d.m.th. para se të merren në pyetje nga policia, pas një hetimi, pas heqjes së lirisë ose pas thirrjeve për t'u paraqitur në gjykatë).⁶⁶

49. **Direktiva e Fëmijëve** përputhet (dhe ndoshta ngritët mbi) qëndrimin e marrë nga GJEDNJ në rastin *Salduz kundër Turqisë*, që theksoi se e drejta për t'u mbrojtur personalisht ose përmes ndihmës juridike është veçanërisht e rëndësishme para dërgimit të një rasti për gjykim. Avokatëve u përkujtohet që edhe pse *Salduz* ka implikime të konsiderueshme mbi të drejtën e qasjes tek një avokat për të gjithë personat e dyshuar dhe të akuzuar, rasti ka të bëjë me një të mitur që i është mohuar qasja tek një avokat pas arrestimit të tij. Sipas *Salduz*, të drejtat e mbrojtjes në parim do të cenohen në mënyrë të pakthyeshme kur deklaratat inkriminuese të bëra gjatë marrjes në pyetje nga policia pa pasur qasje në avokat përdoren për dënim, pavarësisht se a ka pasur arsye bindëse për të arsyetuar mohimin e qasjes në avokat.⁶⁷
50. Megjithatë, në rast e mëvonshme, GJEDNJ ka sugjeruar që këto vendime nuk përbëjnë një “rregull të qartë (bright-line rule)”. Në vitin 2016, GJEDNJ vendosi në rastin *Ibrahim & të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* që mungesa e arsyeve bindëse kur një i dyshuar nuk ka qasje tek një avokat nuk përbën në vetvete shkelje të nenit 6 të KEDNJ.⁶⁸ Gjatë shqyrtimit të procedurës në tërësi, GJEDNJ i kushton rëndësi një liste jo-shteruese faktorësh, ku cenueshmëria dhe mosha e të dyshuarit ose të akuzuarit listohet si një faktor i rëndësishëm.⁶⁹ Megjithatë, nuk është e qartë se çfarë rëndësie i kushton GJEDNJ këtij faktori në vlerësimin e saj të përgjithshëm të paanësisë së procedurës.

Derogimet

51. **Direktiva e Fëmijëve** në mënyrë eksplicite njeh se ka kufizime në të drejtën për ndihmë juridike.⁷⁰ Sipas nenit 6(6) të Direktivës, derogimet lejohen kur ndihma e një avokati nuk do të ishte proporcionale në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh seriozitetin e veprës penale të pretenduar, kompleksitetin e rastit dhe masat që mund të merren në lidhje me një vepër të tillë, duke u kuptuar se interesi më i mirë i fëmijës gjithmonë duhet të jetë një konsideratë parësore. Nuk ka derogim nga e drejta e fëmijës për qasje tek një avokat në ndonjë rast, qoftë gjatë paraburgimit, kur sillet para një gjykatësi për të vendosur mbi paraburgimin në çfarëdo faze të procedurës, kur i shqiptohet heqja e lirisë si sanksion penal, ose gjatë seancave gjyqësore para gjykatës.⁷¹
52. Shtetet Anëtare mund po ashtu të derogojnë përkohësisht nga detyrimi për t'u siguruar që fëmijët ndihmohen nga një avokat në raste të jashtëzakonshme në fazat para gjykimit, deri në masën e justifikuar nga rrethanat e rastit. Kjo është e mundshme nëse është rast urgjent për të shmangur pasojat e rënda negative për jetën, lirinë ose integritetin fizik të një personi, ose kur veprimi i menjëhershëm i autoriteteve hetimore është i domosdoshëm për të parandaluar rrezikun substancial të procedurave penale në lidhje me një vepër të rëndë penale.

⁶⁵ Direktiva e Preambulës së Fëmijëve, para. 25.

⁶⁶ Neni 6(3) i Direktivës së Fëmijëve.

⁶⁷ GJEDNJ *Salduz kundër Turqisë* (2009), apl. nr. 36391/02, para. 55.

⁶⁸ GJEDNJ *Ibrahim & të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar* (2016) apl. nr. 50541/08, 50571/08, 50573/08 dhe 40351/09 para. 262.

⁶⁹ Supra, para. 274.

⁷⁰ Është paraparë që e drejta për ndihmë juridike të ketë implikime të konsiderueshme financiare për Shtetet Anëtare dhe një klauzolë proporcionality është futur në Direktivën e Fëmijëve (Cras 2016, 113).

⁷¹ Neni 6(6) Direktiva e Fëmijëve.

53. Prapë, duhet të merren parasysh interesat më të mirë të fëmijës. Vendimi për të vazhduar me marrjen në pyetje pa praninë e avokatit, sipas këtij derogimi, mund të merret vetëm në baza rast-pas-rasti, qoftë nga një autoritet gjyqësor, ose nga ndonjë autoritet tjetër kompetent, me kusht që vendimi mund të dorëzohet për shqyrtim gjyqësor.⁷² Dispozitat në lidhje me derogimin e së drejtës për qasje në avokat pasqyrojnë në masë të madhe ato në lidhje me të drejtën për qasje tek një avokat në nenet 3 dhe 8 të Direktivës për të Drejtën për Qasje tek një Avokat, dhe ka diskutime të mëtejshme të derogimeve në pakon e Gjykimeve të Paanshme në Direktivën e Avokatit.

Heqja dorë

54. Si personat tjerë të dyshuar dhe të akuzuar, fëmijët shpesh janë nën presion që të heqin dorë nga disa të drejta para caktimit të një avokati. Megjithatë, duke pasur parasysh përvojën e tyre më të pakët dhe kapacitetet më të kufizuara për gjykim dhe vendimmarrje, ka gjasa që fëmijët do të jenë më të prirë ndaj presionit sesa të rriturit. Për të dhënë një shembull të zakonshëm, një fëmijës të cilit i thotë një zyrtar i policisë se “nuk ke nevojë për avokat dhe se me gjasë do të jetë i lirë të largohet pasi t’iu përgjigjet disa pyetjeve” ka shumë më pak gjasa të këmbëngulë që të ketë një avokat të pranishëm sesa një i rritur.

55. Direktiva e Qasjes në Avokat njeh se mund të hiqet dorë nga e drejta e qasjes tek një avokat, përderisa personi i dyshuar ose i akuzuar është pajisur me informata të mjaftueshme për të drejtat e tij dhe pasojat e heqjes dorë, dhe heqja dorë jepet vullnetarisht dhe pa mëdyshje.⁷³ Propozimi fillestar për **Direktivën e Fëmijëve** përfshinte një propozim të qartë që thoshte se një fëmijë nuk mund të heqë dorë nga e drejta për qasje tek një avokat,⁷⁴ por kjo u hoq më pas. **Direktiva e Fëmijëve** ekzistuese nuk ka ndonjë referencë të qartë për heqjet dorë, por mund të argumentohet se fëmijët nuk mund të heqin dorë nga e drejta e tyre për ndihmë juridike (për dallim nga e drejta për qasje në avokat).

56. Me jurisprudencën e GJEDNJ-së është e qartë se fëmijët mund të heqin dorë nga e drejta për qasje në avokat, edhe pse implikimet praktike të kërkesave për një gjë të tillë nuk janë të sqaruara. GJEDNJ konsideroi se kjo heqje dorë duhet të shprehet në mënyrë të qartë dhe pa mëdyshje, dhe se fëmija duhet të jetë në gjendje të parashikojë në mënyrë të arsyeshme se cilat janë pasojat e sjelljes së tij.⁷⁵ GJEDNJ konsideroi që duke pasur parasysh cënueshmërinë e një të mituri të akuzuar dhe mosbalancën e pushtetit të cilit i nënshtrohet për nga vetë natyra e procedurës penale, një heqje dorë nga ndihma juridike nga ai ose në emër të tij mund të pranohet vetëm pasi autoritetet të kenë marrë të gjitha hapat e arsyeshëm për t’u siguruar që ai është plotësisht i vetëdijshëm për të drejtat e tij të mbrojtjes dhe mund të vlerësojë, për aq sa është e mundur, pasojat e sjelljes së tij.⁷⁶ Nuk është e qartë se çfarë GJEDNJ konsideron “të qartë” dhe “pa mëdyshje”, por është e qartë se transmetimi i informacionit mbi të drejtën për ndihmë juridike tek prindi përderisa fëmija është duke u marrë në pyetje, nuk plotëson standardet e kërkuara.⁷⁷

57. Ky qëndrim është kundërshtuar. Është sugjeruar që nevoja për t’i siguruar fëmijës mbrojtje është më e madhe se detyrimi për t’i siguruar atyre autonomi, dhe fëmijëve nuk duhet t’u lejohej që të heqin

⁷² Neni 6(8) Direktiva e Fëmijëve.

⁷³ Direktiva për Qasje tek një Avokat, Neni 9, dhe paragrafët 39-41. Paragrafi 55 i kësaj direktive thekson në mënyrë eksplicite se personave të dyshuar dhe të akuzuar, duke përfshirë fëmijët, u sigurohen informata adekuate për të kuptuar pasojat e heqjes dorë sipas direktivës dhe se çdo heqje dorë bëhet vullnetarisht dhe pa mëdyshje.

⁷⁴ Propozimi për një Direktivë të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për masat procedurale për fëmijët e dyshuar ose të akuzuar në procedurën penale (COM/2013/0822 final - 2013/0408 (COD)).

⁷⁵ GJEDNJ *Panovitz kundër Qipros* (2009), apl. nr.4268/04, par. 68 dhe 73.

⁷⁶ Supra, para. 68.

⁷⁷ Supra, par. 70 dhe 77.

dorë nga e drejta e tyre për avokat në një fazë kaq të hershme të procedurës.⁷⁸

58. Neni 6 i **Direktivës së Fëmijëve** është hartuar si detyrim i Shteteve Anëtare që t'i sigurojnë fëmijës ndihmë juridike, në krahasim me detyrimin e Shteteve Anëtare që të ndihmojnë individët që të marrin ndihmë juridike.⁷⁹ Preambula e **Direktivës së Fëmijëve** thotë se ndihma nga një avokat sipas Direktivës presupozon se një fëmijë ka të drejtën për qasje në avokat sipas Direktivës për Qasje në Avokat.⁸⁰ Preambula po ashtu thotë se kur zbatimi i një dispozite të Direktivës për Qasje në Avokat do të pamundësonte që fëmija të ndihmohej nga një avokat, një dispozitë e tillë nuk duhet të zbatohet.⁸¹ Duke pasur parasysh cenueshmërinë e fëmijës gjatë fazave kur **Direktiva e Fëmijëve** kërkon nga shtetet të sigurojnë ndihmë nga një avokat, avokatët mund të avokojnë që të zbatohet interpretimi më i favorshëm i Direktivës. Ky interpretim thekson se shtetet duhet të garantojnë praninë e një avokati, pavarësisht dëshirës së fëmijës për të hequr dorë nga ndihma juridike.

E. Mbrojtja e privatësisë dhe konfidencialitetit

59. E drejta për privatësi e një fëmijë të dyshuar dhe të akuzuar duhet të mbrohet në secilën fazë të procedurave.⁸² Periudha e përfshirë nga "të gjitha fazat e procedurave" fillon me kontaktin fillestar me zbatimin e ligjit (p.sh. kërkesë për informata dhe identifikimi) dhe përfundon vetëm me vendimin përfundimtar nga një autoritet kompetent ose lirimi nga mbikëqyrja, kujdestaria ose heqja e lirisë.⁸³ Kjo ka implikime për publicitetin në lidhje me të dyshuarit fëmijë, konfidencialitetin e komunikimit të fëmijës me avokatin e tij dhe privatësinë e fëmijës gjatë seancave gjyqësore.

60. Neni 14 i **Direktivës për Fëmijët** rithekson që Shtetet Anëtare duhet të marrin të gjitha masat e duhura për të siguruar mbrojtjen e të drejtës së fëmijës për privatësi gjatë procedurave penale. Seancat gjyqësore që përfshijnë fëmijët duhet të mbahen në mënyrë private, ose gjykatat dhe gjyqtarët duhet të lejohen të përdorin lirinë e tyre në këtë drejtim. Ekziston gjithashtu një obligim që Shtetet Anëtare të inkurajojnë vetë-rregullimin nga mediat për të arritur këtë objektiv.

61. Komentari i Rregullës 8 të Pekinit thekson se fëmijët janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj stigmatizimit. Kështu që, asnjë informacion që mund të çojë në identifikimin e një kundërvajtësi fëmijë nuk mund të publikohet.⁸⁴ Autoritetet duhet të kufizojnë komunikatat për shtyp lidhur me fëmijën në vetëm raste shumë të veçanta.⁸⁵ Gazetarët që shkelin të drejtën për privatësi të fëmijës në konflikt me ligjin, duhet të sanksionohen me sanksione disiplinore dhe/ose penale.⁸⁶

62. Ngjashëm, seancat gjyqësore apo seancat tjera duhet të mbahen me dyer të mbyllura (pa qasjen e publikut).⁸⁷ Seancat publike në drejtësinë për të mitur duhet të lejohen vetëm në raste specifike, të shprehura qartë me ligj. Vendimi duhet të shpallet publikisht në seancë gjyqësore në mënyrë të tillë që identiteti i fëmijës të mos zbulohet. Çdo dosje kriminale që lidhet me fëmijën duhet të mbahet konfidenciale në mënyrë strikte, përveç atyre që janë të përfshirë drejtpërdrejt në hetimin, gjykimin si dhe vendimmarrjen mbi rastin.⁸⁸ Transferimi i këtyre të dhënave duhet të bëhet vetëm në

⁷⁸ Liefaard & Van den Brink 2014, 214.

⁷⁹ Shihni tekstin e nenit 6(2) Direktiva e Fëmijëve; "Shtetet Anëtare sigurojnë që fëmijët të ndihmohen nga një avokat (...)." Shihni gjithashtu Cras 2016.

⁸⁰ Paragrafi 25 Direktiva e Fëmijëve.

⁸¹ Paragrafi 26 Direktiva e Fëmijëve.

⁸² Neni 16 i KDF dhe GC 10, para.64

⁸³ GC 10, 64. Shih gjithashtu Rregullat e Pekinit 8.1.

⁸⁴ Rregullat e Pekinit 8.2. Udhëzuesi 6.

⁸⁵ GC 10, para. 65.

⁸⁶ GC 10, para. 65.

⁸⁷ GC 10, para. 66, Udhëzuesi 9

⁸⁸ GC 10, para. 66.

përputhje me interesin më të mirë të fëmijës dhe me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave.⁸⁹

63. Mbrojtja e privatësisë së fëmijës plotëson detyrimin e avokatit, ekzistues në të gjitha vendet evropiane, për t'i mbajtur konfidenciale çështjet e klientëve.⁹⁰ Që avokatët të jenë efektivë në mbrojtjen e të drejtave të klientëve të tyre, duhet të ketë besim se komunikimet ndërmjet tyre dhe klientëve të tyre mbahen konfidenciale. Neni 6 i **Direktivës për Fëmijët** përcakton shprehimisht se e drejta e fëmijës për ndihmë nga një avokat përfshin të drejtën e konfidencialitetit mes avokatit dhe fëmijës dhe e drejta për konfidencialitet është e paderogueshme. Shteti duhet të sigurojë privatësinë dhe konfidencialitetin e komunikimit ndërmjet fëmijës që është ndaluar ose arrestuar dhe avokatit të tij.⁹¹ Avokatët duhet të jenë në gjendje të vizitojnë fëmijën pa kufizime dhe pa mbikëqyrje.⁹²
64. Edhe vetë avokatët duhet të respektojnë rregullat e konfidencialitetit në mënyrë strikte. Pa një garanci reale që komunikimet avokatin e tyre janë të privileguara, ekziston rreziku që fëmija nuk do t'i besojë avokatit për të zbuluar informata të mëtejshme relevante. Prandaj, një shkelje e këtij lloji përbën shpesh mohimin e përfaqësimit efektiv të fëmijës.⁹³ Përgjashtimi i vetëm është kur ekziston një rrezik real për dëmtim të fëmijës, që do të thotë se në një rast të tillë informacionet e zbuluara në mënyrë konfidenciale duhet të ndahen me profesionistë të tjerë me qëllim që të parandalohen dëmtime të mëtejshme të fëmijës.⁹⁴

1.1.

IV. ZBATIMI PRAKTIK I DIREKTIVËS PËR FËMIJËT

65. Seksionet e mëhershme kanë dhënë një përmbledhje të të drejtave që u sigurohen fëmijëve sipas të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane, veçanërisht **Direktivës për Fëmijët**. Ky seksion përshkruan implikimet praktike të Direktivës dhe standardeve të tjera ndërkombëtare dhe rajonale në fazat e ndryshme të procedurave penale.

A. Arrestimi dhe marrja në pyetje nga policia

66. Fazat fillestare të procedurave penale, në të cilat një fëmijë mund të arrestohet dhe të merret në stacionin policor, shpesh do të jenë kontakti i parë i fëmijës me policinë dhe sistemin e drejtësisë penale. Ky është moment kritik dhe stresues për çdo person të dyshuar ose të akuzuar, por është veçanërisht sfidues për fëmijët. Fëmijët mund të jenë të frikësuar, të dëshpëruar dhe të hutuar kur arrestohen dhe janë veçanërisht të cenusëm gjatë momenteve menjëherë pas arrestimit dhe gjatë marrjes në pyetje.
67. Roli i avokatit në këtë takim të parë është thelbësor: fëmija ka nevojë për mbështetje të përshtatshme në një moment të stresit intensiv dhe që t'i mbrohen të drejtat sa më shumë që është e mundur nga fillimi i procedurave. Në këtë moment delikat, avokati duhet të krijojë një marrëdhënie me klientin e tyre, duke përdorur aftësitë e komunikimit, të kuptuarit zhvillimor dhe instrumentet ligjore të diskutuara në kapitujt e mëparshëm.
68. Avokatët nuk janë të vetmit që kanë për detyrë të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të fëmijës. Kjo detyrë ndahet me akterë të tjerë në sistemin e drejtësisë për të miturit, duke

⁸⁹ Udhëzuesi 8

⁹⁰ CCBE 2016, fq. 9, shih gjithashtu Udhëzuesin 10.

⁹¹ Rregullat e Havanës 18(a); Rregulli evropian 120.2.

⁹² Rregulli Evropian 120.2.

⁹³ CCBE 2016, 9.

⁹⁴ Udhëzuesi 10.

përfshirë edhe oficerët e policisë, të cilët janë të detyruar ligjërisht në bazë të nenit 3 të KDF për të trajtuar interesat më të mira të fëmijës si një konsideratë parësore. Megjithatë, procesi i arrestimit dhe marrjes në pyetje, nuk është i dizajnuar që t'i jap më shumë efekt këtij detyrimi, sepse këto procese kryesisht janë të krijuara për të nxjerr rrëfime dhe informata të dobishme për policinë gjatë hetimit penale në vazhdim. Në disa vende, oficerët e policisë marrin një trajnim të posaçëm për të siguruar që sjellja dhe procedurat e tyre janë të përshtatura posaçërisht për fëmijët, por trajnimi i tillë nuk është gjithnjë i efektshëm dhe avokatët duhet gjithmonë të marrin një qasje të kujdesshme për të siguruar që oficerët e policisë veprojnë në interesin më të mirë të klientëve të tyre fëmijë.

E drejta për ndihmë juridike

69. Prania e avokatit dhe ndihma juridike në stacionin policor i ndihmon fëmijët të qasen në të drejtat e tyre për gjykime të drejta, duke përfshirë ato që janë specifike për të dyshuarit dhe të pandehurit fëmijë. Për shembull, avokatët mund të luajnë një rol thelbësor në sigurimin që fëmijët kuptojnë të drejtat e tyre dhe që ata përfitojnë nga përshtatjet procedurale që do t'u mundësonin atyre të marrin pjesë në mënyrë efektive gjatë momenteve thelbësore fillestare të procedurës së tyre penale. Për këto arsye, në përgjithësi është në interes të fëmijës që avokatët të emërohen sa më shpejt që të jetë e mundur pasi fëmija bie në kontakt me sistemin e drejtësisë penale si i dyshuar ose i akuzuar.

Fushëveprimi i së drejtës për qasje në ndihmë juridike

70. Siç është përmendur në par. 1.2.4, Neni 6 i **Direktivës për Fëmijët** kërkon që Shtetet Anëtare të sigurojnë që një i dyshuar ose i akuzuar fëmijë të ndihmohet nga një avokat. Neni 6 e bën të qartë se një i dyshuar ose i akuzuar fëmijë ka të drejtën për qasje në ndihmë juridike që nga momenti më i hershëm i procedurës penale. Më konkretisht, kjo dispozitë parasheh që fëmijët duhet të ndihmohen nga avokati "pa vonesa të panevojshme" sapo të njoftohen se janë persona të dyshuar ose të akuzuar, duke përfshirë para se të merren në pyetje nga policia ose autoriteti gjyqësor dhe pas privimit të lirisë.⁹⁵
71. Preambula e **Direktivës për Fëmijët** megjithatë e bën të qartë se detyrimi i Shteteve Anëtare që të sigurojnë ndihmën e një avokati për fëmijët nuk përfshin sigurimin e mbështetjes gjatë fazave të identifikimit të fëmijës; përcaktimin nëse duhet të iniciohet një hetim; ose verifikimin e posedimit të armëve ose çështjeve të tjera të ngjashme të sigurisë. As nuk përfshin kryerjen e akteve hetimore ose të mbledhjes së dëshmive, përveç atyre të përmendura në Direktivë, të tilla si kontrollet e trupit, ekzaminimet fizike, testet e gjakut, alkoolit ose të ngjashme, ose marrjen e fotografive ose shenjave të gishtërinjve; ose sjelljen e fëmijës para një autoriteti kompetent ose dorëzimin e fëmijës tek mbajtësi i përgjegjësishë prindërore ose tek një i rritur tjetër adekuat, në përputhje me ligjin kombëtar.⁹⁶
72. **Direktiva për Fëmijët** pasqyron dispozitat që gjenden në Direktivën për Qasjen në Avokat duke konfirmuar se ndihma juridike përfshin konsultimet private mes avokatit dhe klientit para marrjes në pyetje, si dhe pjesëmarrjen efektive gjatë marrjes në pyetje.⁹⁷ Me fjalë të tjera, Shtetet Anëtare nuk kërkohet vetëm që të sigurojnë që një avokat është i pranishëm gjatë marrjes në pyetje nga policia, por gjithashtu duhet t'u lejojë atyre të marrin një rol aktiv gjatë marrjes në pyetje. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të dyshuarit dhe të pandehurit fëmijë që mund të kërkojnë ndërprerje dhe ndërhyrje nga avokatët e tyre gjatë marrjes në pyetje për të siguruar që ata të

⁹⁵ Pikat e tjera në të cilat duhet të ofrohet ndihma juridike përfshijnë periudhat gjatë akteve hetimore, gjatë konfrontimeve dhe rikonstruktimit e skenave të krimit, dhe pasi të thirren për t'u paraqitur në gjykatë.

⁹⁶ Direktiva për Fëmijët, Recitali 28.

⁹⁷ Direktiva për Fëmijët, Neni 6 (4).

dëgjoen dhe që po merren parasysh interesat e tyre më të mira.

Derogimet dhe dorëheqjet

73. E drejta për ndihmë juridike sipas **Direktivës për Fëmijët** nuk është absolute. Derogimet lejohen. Duke qenë se Neni 6 i Direktivës nuk është përkufizuar si një e drejtë e fëmijëve, por si detyrim ndaj Shteteve Anëtare, duket se fëmijët nuk mund (sipas opinionit tonë) të heqin dorë nga e drejta e tyre për ndihmë juridike (shih paragrafin 1.2.4). Sidoqoftë, sipas nenit 6(6) të Direktivës, derogimet nuk janë të lejueshme gjatë ndalimit dhe kjo duket të përfshijë rastet në të cilat një fëmijë ndalet nga policia. Në praktikë, avokatët mund të mos kenë gjithmonë rol ndikues në përcaktimin se si vendimet në lidhje me derogimet dhe dorëheqjet bëhen gjatë fazave fillestare të procedurave penale, por në këto situata, roli i akterëve të tjerë, si mbajtësit e përgjegjësishë prindërore dhe të rriturve mund të jetë i rëndësishëm. Ata mund të ndihmojnë për të siguruar që fëmija të marrë një vendim të informuar në lidhje me marrjen e ndihmës juridike dhe t'i rezistojë presionit nga zyrtarët e policisë të cilët mund të përpiqen të ja ndryshojnë mendjen fëmijës sa i përket marrjes së një avokati.

Pjesëmarrja efektive

74. Avokatët duhet të sigurohen që fëmijët janë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë efektive gjatë marrjes në pyetje nga policia. Kjo nuk përmbushet vetëm duke siguruar që fëmijëve iu parashtrohen pyetje dhe iu jepet mundësia të përgjigjen. Në vend të kësaj, avokati dhe akterët e tjerë në procedurë duhet të sigurohen që fëmija të kuptojë pyetjet që i parashtrohen, si dhe implikimet dhe pasojat e mundshme që rezultojnë nga përgjigjet që mund të japin si dhe heshtja. Avokatët mund dhe duhet të sigurojnë që çështjet dhe veprimet e policisë janë të përshtatshme për nevojat dhe karakteristikat e fëmijës dhe se përgjigjet dhe sjelljet e fëmijës nuk keqinterpretohen. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur fëmijët kanë aftësi të kufizuara ose vështirësi në të nxënit që duhet të merren parasysh.
75. Kjo nënkupton se është veçanërisht e rëndësishme që avokatët të kenë mundësinë të njohin klientët e tyre fëmijë dhe të vlerësojnë nevojat dhe mundësitë e tyre para marrjes në pyetje. Nëse është e mundur, gjithashtu sigurohuni që një vlerësim i duhur mjekësor dhe individual të bëhet në fazën e hershme, në mënyrë që të mund të kërkohen përshtatje përkatëse procedurale.

E drejta për t'u dëgjuar

76. Avokatët kanë një rol të rëndësishëm për të siguruar që të dëgjohen pikëpamjet e fëmijës (në vend të atyre të prindërve apo avokatit). Kjo përfshin edhe sigurimin që fëmija mund të tregojë ngjarjet e veta pa u ndikuar nga frikësimi, por gjithashtu duke siguruar që fëmija të jetë sa më i lirë që të japë llogari për ngjarjet dhe jo të dekurajohet, për shembull, nga dhënia e një përgjigje të veçantë sepse ata janë të zënë ngushtë nga reagimi i një prindi, ose për shkak se kanë frikë nga inkriminimi i dikujt tjetër. Avokatët duhet jo vetëm të sigurojnë që zëri i fëmijës të dëgjohet gjatë marrjes në pyetje nga policia, por gjithashtu të sigurohet se ata e kuptojnë këtë përpara marrjes në pyetje, në mënyrë që ata të informohen siç duhet dhe të jenë në pozitë që t'i japin peshë atyre pikëpamjeve
77. Gjatë marrjes në pyetje nga policia, e drejta për t'u dëgjuar duhet gjithashtu të jetë e balancuar me të drejtën për të heshtur dhe avokati duhet të këshillojë klientin për strategjinë e duhur për t'u përdorur gjatë marrjes në pyetje nga policia. Sidoqoftë, avokatët duhet të jenë të kujdesshëm gjatë këshillimit të klientëve të tyre fëmijë për të shfrytëzuar të drejtën e tyre për të heshtur. Është sugjeruar që avokatët shpesh janë shumë të etur që të këshillojnë këtë strategji, madje edhe në raste të vogla në të cilat duket qartë se faji është i fëmijës. Mbështetja në të drejtën për të heshtur mund të parandalojë përdorimin e mekanizmave të diversionit, të cilat mund të kërkojnë bashkëpunimin e fëmijës.⁹⁸
78. Siç u diskutua më herët, **Direktiva e fëmijëve** kërkon nga shtetet anëtare tu mundësojnë avokatëve të marrin pjesë në mënyrë aktive gjatë marrjes pyetje nga policia. Kjo nënkupton që avokatët duhet të jenë në gjendje të ndërhyjnë, për shembull, për të siguruar që pyetjet të formulohen në atë mënyrë që klienti i tyre fëmijë mund t'i kuptojë, të kontrollojë që klienti i tyre fëmijë i ka kuptuar pyetjet dhe gjithashtu të sigurojë që përgjigjet e tyre të mos keqinterpretohen. Avokatët duhet të jenë gjithashtu të përgatitur të ndërpresin dhe të protestojnë kur marrja në pyetje është e padrejtë ose nëse sjellja e zyrtarit policor është tepër e frikshme.
79. Ka më shumë gjasa që fëmijët të marrin pjesë në mënyrë efektive nëse ndihen rehat. Kjo do të thotë, për shembull, se avokatët duhet të sigurojnë që fëmijëve u ofrohen periudha adekuate të pushimit, ushqim dhe pije, veçanërisht nëse ata janë në rrezik të ndjehen të mbingarkuar. Kjo është pjesë e procesit të sigurimit të mirëqenies së përgjithshme të fëmijës, por avokatët duhet të kenë parasysh se mund të ketë një efekt shumë të drejtpërdrejtë në aftësinë e fëmijës për pjesëmarrje efektive.

⁹⁸ Liefwaard & Van den Brink 2014

80. Roli i aktorëve të tjerë
81. Roli i aktorëve të tjerë mund të jetë i dobishëm për të siguruar që fëmija të dëgjohej. Avokatët mund dhe duhet të përpiqen të njohin klientët e tyre në mënyrë që ata të mund të identifikojnë nevojat e tyre dhe të vlerësojnë aftësitë e tyre. Megjithatë, në praktikë, koha që u jepet avokatëve për ta bërë këtë para marrjes në pyetje të policisë shpesh është e pamjaftueshme dhe në këto situata roli i të tjerëve që e njohin më mirë fëmijën, përfshirë punonjësit socialë dhe ata me përgjegjësi prindërore, mund të jetë shumë i rëndësishëm. Për shembull, ata mund të kenë njohuri paraprake mbi aftësitë e komunikimit dhe gjuhës së fëmijës, që mund të ndihmojnë në sigurimin që pikëpamja e fëmijës të dëgjohej.
82. Sipas **Direktivës së fëmijëve**, shteteve anëtare u kërkohet të sigurojnë që fëmijët janë të shoqëruar nga një mbajtës i përgjegjës prindërore ose një i rritur gjatë procedurave të tyre ligjore, për aq sa konsiderohet se kjo do të ishte në interesin e tyre më të mirë dhe prania e atij personi nuk i cenon procedurat.⁹⁹ Preambula e Direktivës konsideron marrjen në pyetje nga policia si një fazë në të cilën duhet të zbatohet ky detyrim.¹⁰⁰ Një fytyrë e njohur në një kohë stresuese mund të ndihmojë fëmijët të ndihen më rahat dhe t'i ndihmojë ata të shprehin pikëpamjet e tyre, por siç u përmend më lart, mbajtësit e përgjegjës prindërore mund të ketë gjithashtu një ndikim të dëmshëm në të drejtën e fëmijës për t'u dëgjuar. Kjo është veçanërisht e vërtetë nëse prindërit marrin një rol tepër aktiv gjatë marrjes në pyetje, ose nëse fëmijët ndihen të frikësuar ose të zënë ngushtë për të folur hapur në praninë e tyre.

E drejta e informimit

83. Aftësia e një fëmije për të kuptuar pozitën e tyre dhe për të kuptuar informacionin që u është dhënë nga policia dhe avokati i tyre në përgjithësi është më i kufizuar se ai i një të rrituri, për shkaqet e diskutuara në Kapitullin 2. Edhe avokatët duhet të kenë parasysh se një fëmijë i cili është arrestuar nga policia mund të hasë në sistemin e drejtësisë për herë të parë dhe ata mund të e përjetojnë këtë përvojë më vështirë se shumica e të rriturve. Avokati duhet të bëjë kujdes të veçantë për të siguruar që një fëmijë i dyshuar të kuptojë informacionin që u është dhënë atyre, qoftë duke e interpretuar atë vetë ose duke nxitur policinë të përdorë një gjuhë të thjeshtë, miqësore me fëmijët dhe duke shpjeguar implikimet për rastin.
84. Siç u shpjegua më herët, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, fëmijët duhet të kenë njohuri të “gjera” të procesit, dhe asaj që është në rrezik.¹⁰¹ Kjo nënkupton se avokatët duhet të sigurojnë që klientët e tyre fëmijë i kuptojnë aspektet më të rëndësishme të ligjeve dhe procedurave të zbatueshme, si një minimum i elementeve të përcaktuara në nenin 4 (e drejta për informim) të **Direktivës së fëmijëve**, për t'i mundësuar fëmijës pjesëmarrje efektive në procedura.

Fushëveprimi i të drejtës për informim

85. Direktiva për informim përmban dispozita rreth fushëveprimit të informatave që duhet t'u sigurohen të dyshuarve dhe personave të akuzuar, pavarësisht moshës së tyre, si dhe mënyrës në të cilën duhet të sigurohet një informatë e tillë. Në veçanti, të gjithë të dyshuarit dhe personat e akuzuar duhet të informohen menjëherë për disa të drejta procedurale dhe për informimin rreth veprës penale për të cilën dyshohen ose akuzohet se kanë kryer.¹⁰²

⁹⁹ Direktiva e fëmijëve, neni 15(4).

¹⁰⁰ Direktiva e fëmijëve, Recitali 59.

¹⁰¹ GJEDNJ S.C. kundër Mbretërisë së Bashkuar (2004), appl. nr. 60958/00

¹⁰² Direktiva për informim, nenet 3, 4 dhe 6.

86. **Direktiva e fëmijëve** riafirmon se ekziston një detyrim specifik ndaj shteteve anëtare për të informuar fëmijët për të drejtat e tyre dhe i referohet Direktivës së Informimit, por më tej i shtjellon të drejtat që duhet të ofrohen dhe mënyrës se si dhe kur duhet të bëhet kjo. Neni 4(1) i **Direktivës së fëmijëve** pranon se ekzistojnë të drejta të ndryshme që duhet t'u shpjegohen fëmijëve në faza të ndryshme të procedurave. Ajo parashikon që menjëherë kur fëmija bëhet i vetëdijshëm se është i person i dyshuar ose i akuzuar duhet të sigurohen të drejtat e mëposhtme:
- a) E drejta për të informuar bartësin e përgjegjesisë prindërore;
 - b) E drejta për t'u ndihmuar nga avokati;
 - c) E drejta për mbrojtjen e privatësisë;
 - d) E drejta për t'u shoqëruar nga mbajtësi i përgjegjesisë prindërore gjatë fazave të procedurave, përveç seancave gjyqësore; dhe
 - e) E drejta për ndihmë juridike.
87. Direktiva gjithashtu specifikon se disa të drejta duhet t'i shpjegohen fëmijës “në fazën më të hershme të përshtatshme” dhe të tjerave “pas heqjes së lirisë”, të cilat diskutohen më hollësisht më vonë, por është e rëndësishme të theksohet se në mesin e këtyre të drejtave ekziston e drejta për një vlerësim individual, e drejta për ekzaminim mjekësor, e drejta e kufizimit të privimit të lirisë, e drejta e trajtimit të veçantë gjatë privimit të lirisë, të gjitha këto mund të jenë të rëndësishme në fazat shumë të hershme të procedurës. Prandaj, avokatët duhet të sigurojnë që informacioni për këto të drejta t'u vihet në dispozicion edhe fëmijëve në fazën më të hershme të mundshme.

Procedura

88. **Direktiva e fëmijëve** e bën të qartë se informimi duhet të ofrohet me gojë, me shkrim ose me të dyja, në një gjuhë të thjeshtë dhe të qasshme, dhe ashtu siç përcaktohet me Direktivën për informim, fëmijëve duhet t'i jepet dokumenti i të drejtave. Avokatët duhet të vënë në dukje se detyrimi për t'u ofruar fëmijëve dokumentin e të drejtave nuk përmbushet duke i ofruar fëmijëve të njëjtin dokument të të drejtave që u jepet të rriturve. Jo vetëm se gjuha e përdorur në dokumentin e të drejtave mund të mos jetë e kuptueshme për fëmijët, por gjithashtu sepse nuk do të përmbajë informata për të drejtat që janë specifike për fëmijët.¹⁰³
89. Në disa juridiksione, si Angli dhe Uells, zyrtarët policor shpesh përdorin dokumentet e të drejtave që janë përshtatur në mënyrë specifike për fëmijët me qëllim që të sigurojnë informata për të drejtat e tyre, por avokatët nuk duhet të supozojnë se vetëm përdorimi i procedurave të veçanta nuk do të sigurojë që fëmijët të kuptojnë të drejtat e tyre, por që atyre duhet t'u jepet informacion i saktë për të drejtat e tyre.

Regjistrimi audio-vizual

90. **Direktiva e fëmijëve** kërkon që shtetet anëtare të sigurojnë që marrja në pyetje e fëmijëve regjistrohet në mënyrë audio-vizuale, kur kjo është “proporcionale me rrethanat e rastit”, dhe në interesin më të mirë të fëmijës. Vendimet mbi proporcionalitetin e regjistrimit audio-vizual në një rast specifik duhet të marrin parasysh, mes tjerash, se a është i pranishëm avokati apo jo dhe nëse fëmija është i privuar nga liria ose jo.¹⁰⁴ Nëse nuk bëhet regjistrimi, pyetjet duhet të regjistrohen në një mënyrë tjetër të përshtatshme, siç është procesverbali i verifikuar me shkrim.¹⁰⁵
91. Regjistrimi audio-vizual mund të jetë një mbrojtje efektive që ndihmon për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të personave të dyshuar dhe të akuzuar gjatë marrjes në pyetje nga policia. Për shembull, mund të veprojë si një pengesë e fuqishme ndaj keqtrajtimit ose të teknikave detyruese të marrjes

¹⁰³ Direktiva e fëmijëve, neni 4(3).

¹⁰⁴ Direktiva e fëmijëve, neni 9(1).

¹⁰⁵ Direktiva e fëmijëve, neni 9(2).

në pyetje, dhe mund të japë dëshmi për nivelin e pjesëmarrjes efektive të fëmijës, nëse kjo bëhet çështje në një fazë të mëvonshme. Regjistrimi gjithashtu mund të mbrojë punonjësit e policisë nga akuzat e pajustificuara të trajtimit të dobët, duke u mundësuar atyre që të demonstrojnë se kanë trajtuar në mënyrë të drejtë një fëmijë.¹⁰⁶ Megjithatë nuk është një detyrim absolut, pasi që autoritetet kanë diskrecion sipas **Direktivës së Fëmijëve** për të vendosur nëse regjistrimi është proporcional. Në praktikë, regjistrimi duhet të kërkohet në pothuajse të gjitha rastet dhe avokatët duhet të tregojnë avantazhet e regjistrimit audio-vizual si për klientët e tyre ashtu dhe për punonjësit e policisë.

Privatësia dhe konfidencialiteti

92. Siç është përmendur më parë, avokatët duhet t'i mbajnë çështjet midis tyre dhe klientëve të tyre në mënyrë strikte konfidenciale dhe kjo përforcohet nga neni 14 i Direktivës së Fëmijëve, që vlen gjatë gjithë procedurës. Direktiva përcakton më tutje (në një dispozitë të pa derogueshme) se shtetet anëtare duhet të respektojnë konfidencialitetin e komunikimit ndërmjet fëmijëve dhe avokatëve të tyre. Ky komunikim përfshin takime, korrespondenca, biseda telefonike dhe forma të tjera të komunikimit të lejuara sipas ligjit kombëtar.¹⁰⁷ Shtetet duhet ta respektojnë këtë konfidencialitet dhe nuk mund të ndërpresin komunikimin midis një avokati dhe një klienti.
93. Neni 6(5) i **Direktivës së fëmijëve** duket se është i pa derogueshëm, por kjo dispozitë nuk paragjykon procedurat që trajtojnë situatën kur ekziston dyshimi se avokati është i përfshirë me fëmijën në një vepër penale.¹⁰⁸ Për më tepër, nuk paragjykon shkeljen e konfidencialitetit që është e rastësishme për një veprim mbikëqyrës të ligjshëm nga organet kompetente dhe për punën që kryhet, për shembull, nga shërbimet kombëtare të inteligjencës për të mbrojtur sigurinë kombëtare.¹⁰⁹

Diversioni

94. Pasi që avokatët të kenë një pasqyrë të qartë dhe holistike të situatës së fëmijës, ata munden, për sa kohë që kjo është në interesin më të mirë të fëmijës dhe në pajtim me pikëpamjet e fëmijës, të përpiqen të drejtojnë policinë drejt devijimit të rastit nga vepra penale sistemin e drejtësisë. Avokatët duhet të jenë të ndërgjegjshëm se objektivat e drejtësisë për të mitur dekurajojnë një qasje thjesht ndëshkuese,¹¹⁰ kështu që kur diversioni ofron një mundësi më të mirë për të riintegruar fëmijën përsëri në shoqëri, duhet të zgjidhet kjo mundësi. Avokati luan një rol thelbësor në avokimin për një masë të tillë. Programet e diversionit dallojnë shumë nga vendi në vend dhe avokatët duhet të kenë një kuptim të mirë të programeve të tilla, në mënyrë që të përcaktojnë nëse devijimi do të ishte në interesin më të mirë të klientëve të tyre fëmijë. Vlerësimi individual mund të ndihmojë për të përcaktuar përshtatshmërinë e devijimit.
95. Ndoshta, zakonisht është në interes të fëmijës që të shmanget nga sistemi i drejtësisë. Programet që i lejojnë fëmijët të mbajnë lidhjet e tyre familjare dhe të vazhdojnë shkollimin duket se japin rezultate më të mira se burgjet në të cilat jeta familjare, arsimit dhe puna janë të një standardi të ndryshëm.¹¹¹ Paraburgimi (sidomos kur fëmijët vendosen në izolim) tenton të sjellë nivele më të ulëta të arsimimit dhe shkallë më të lartë të shkeljes së serishme të ligjit dhe kriminalitetit. Ndikimi në individ nuk është më pak i dëmshëm, duke lënë shumë të dënuar me pasoja mendore dhe emocionale, duke humbur lidhjen e tyre me burimet ose sistemet mbështetëse kur kthehen në komunitet.¹¹²
96. Në shumë vende, policia ka diskrecion të gjerë për të larguar rastet e të miturve nga sistemi duke i

¹⁰⁶ Cras 2016, f. 116

¹⁰⁷ Neni 6 (5) i Direktivës së fëmijëve. Shih gjithashtu Rregullat e Havanës, Rregulli 18(a).

¹⁰⁸ Direktiva e fëmijëve, Recitali 33.

¹⁰⁹ Direktivës së fëmijëve, Recitali 34.

¹¹⁰ CRC, neni 40(1).

¹¹¹ Polansky 2015 paragr. 53 dhe 56.

¹¹² Polansky 2015 paragr. 55

referuar fëmijës një programi devijimi. Studimet nga Shtetet e Bashkuara mbi natyrën dhe efektet e këtij procesi të diversionit joformal sugjerojnë se faktorët parësorë që ndikojnë në vendimin për diversion në një rast përfshijnë: seriozitetin e veprës penale; moshën e fëmijës; të dhënat e mëparshme të fëmijës për dënimet, akuzat, kontaktet e mëparshme me policinë; raca, gjinia dhe statusi socio-ekonomik i fëmijës; sjellja e fëmijës (të rinjtë që duken të respektueshëm ndaj oficerëve dhe që frikësohen nga sanksionet konsiderohen si "të shpëtueshëm" dhe rrjedhimisht largohen nga sistemi); komentet dhe qëndrimi i prindërve pasi të jenë të informuar për arrestimin e fëmijës (ku zyrtari vlerëson nëse prindërit me gjasë do e ndëshkojnë fëmijën në mënyrë të përshtatshme dhe të kontrollojnë sjelljen e keqe në të ardhmen); dhe, së fundi, ndjenjat personale të zyrtarit individual për efikasitetin e sistemit të drejtësisë për të miturit dhe gjasat që një fëmijë të nxjerrë ndonjë përfitim nga gjykata¹¹³. Avokatët duhet t'ia bëjnë me dije zyrtarëve të policisë këto elemente sa herë që është e favorshme për rastin e fëmijës të bindin zyrtarin policor që ta diversoj rastin.

B. Paraburgimi

97. Privimi i një fëmije nga liria pothuajse kurrë nuk është në interesin e tij më të mirë. Privimi nga liria shkakton pasoja të rënda negative për fëmijët. Edhe periudhat e shkurtra të paraburgimit mund të dëmtojnë mirëqenien psikologjike dhe fizike të fëmijës dhe të komprometojnë zhvillimin kognitiv.¹¹⁴ Fëmijët e privuar nga liria janë në rrezik më të lartë të vuajnë nga depresioni dhe ankthi dhe shfaqin shpesh simptoma të cilat janë në përputhje me çrregullimet e stresit post traumatik. Raportet mbi efektet e privimit të fëmijëve nga liria kanë gjetur shkallë më të lartë të vetëvrasjes dhe vetëdëmtimit, çrregullimeve mendore dhe problemeve zhvillimore.¹¹⁵ Në institucionet anembanë botës ku fëmijët janë të privuar nga liria, ka shqetësime serioze në lidhje me dhunën, duke përfshirë edhe dhunën mes bashkëmoshatarëve, dhunën mes stafit dhe fëmijëve si dhe formave të dhunës së vetë-shkaktuar.¹¹⁶
98. Avokatët duhet t'i ndihmojnë fëmijët në tri mënyra nëse ata janë në paraburgim ose janë në rrezik të paraburgimit. Ata duhet të sigurojnë që klientët e tyre fëmijë të paraburgosen vetëm kur paraburgimi është si e zgjidhja e fundit dhe për periudhën më të shkurtër kohore, duhet të sigurojnë ndihmë ligjore efektive gjatë paraburgimit dhe gjithashtu duhet të ndihmojnë për të siguruar që të drejtat dhe mirëqenia e tyre mbrohen në paraburgim.

Masat e zgjidhjes së fundit dhe për periudhën më të shkurtër të përshtatshme kohore

99. GJEDNJ-ja ka konfirmuar në rastin *Güveç kundër Turqisë* se paraburgimi i fëmijës është vetëm i lejueshëm si masë e zgjidhjes së fundit dhe duhet të jetë për kohën më të shkurtër të mundshme. Ky opinion është miratuar në nenin 10 të [Direktivës së fëmijëve](#), që kërkon nga shtetet anëtare të kufizojnë privimin nga liria të një fëmije në kohën më të shkurtër të mundshme, në cilëndo faze të procedurave, duke pasur parasysh moshën dhe gjendjen individuale të fëmijës, dhe rrethanat e veçanta të rastit në fjalë.¹¹⁷ Për më tepër, shtetet anëtare janë detyruar të shqiptojnë privimin nga liria si zgjidhje e fundit dhe ta bazojnë atë në një vendim të arsyeshëm që është objekt i shqyrtimit gjyqësor nga gjykata.¹¹⁸
100. Duke pasur parasysh ndikimin e dukshëm negativ të paraburgimit tek fëmijët dhe implikimet serioze të të drejtave të njeriut nga privimi nga liria, avokatët duhet të supozojnë se është në interesin më të mirë të fëmijës që të kërkojnë lirimin e tyre. Sidoqoftë, është me rëndësi që avokatët t'i kuptojnë

¹¹³ Hertz et al 2012, f.15.

¹¹⁴ UN Rapporteur on Torture 2015, para. 16.

¹¹⁵ UN Rapporteur on Torture 2015, para. 16.

¹¹⁶ Raporti i përbashkët 2012, para. 8.

¹¹⁷ Direktiva e fëmijëve, neni 10(1).

¹¹⁸ Direktiva e fëmijëve, neni 10(2).

klient dhe rrethanat e tyre. Kjo për arsye se njohuritë për rrethanat e fëmijës mund të forcojnë argumentet në favor të lirimit të tyre dhe të identifikojnë alternativat e përshtatshme për paraburgimin. Avokatët duhet të informohen për çdo faktor që mund të nënkuptojë se lirimi i tyre është kundër interesave të tyre më të mira. Në raste veçanërisht të vështira, fëmijët mund të jenë në rrezik të dëmtimit të drejtpërdrejtë në kujdestarinë e prindërve ose kujdestarëve të zakonshëm, qoftë për shkak të abuzimit ose për shkak të një situatë të vazhdueshme dhe të pasigurt në të cilën nuk plotësohen nevojat e veçanta. Mundësia e rrethanave të tilla e bën më të rëndësishme mundësinë e kërkimit të një vlerësimi individual dhe një ekzaminimi mjekësor

Afatet kohore

101. **Direktiva e fëmijëve** nuk jep një afat kohor minimal për privimin nga liria të fëmijëve (paraburgimin). Ajo që “periudha më e shkurtër e përshtatshme kohore” dhe “masë e zgjedhjes së fundit” nënkupton në raste specifike mbetet e hapur për interpretim. Kjo qasje është në përputhje me atë të marrë nga GJEDNJ-ja në rastin *Nart kundër Turqisë*, në të cilin GJEDNJ-ja vendosi se nuk mund të vlerësohet në mënyrë abstrakte nëse një periudhë paraburgimi është e arsyeshme apo jo. GJEDNJ-ja theksoi se kjo duhet të përcaktohet në baza specifike të rasteve, duke shqyrtuar nëse ekziston një interes i vërtet publik që tejkalon rregullën apo respektimin e lirisë individuale.¹¹⁹
102. Në rastin *Nart kundër Turqisë*, GJEDNJ-ja gjeti shkelje të KEDNJ-së (neni 5(3)), pasi që parashtuesi ishte ende një fëmijë deri sa ishte në paraburgim për dyzet e tetë ditë.¹²⁰ GJEDNJ-ja në rastin *Güveç kundër Turqisë*, në të cilin parashtuesi ishte privuar nga liria në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare dhe u mbajt në paraburgim për një periudhë që tejkalon katër vjet e gjysmë, e konstatoi si të tepruar dhe në kundërshtim me nenin 5(3) të KEDNJ-së.¹²¹ Në rastin *Selçuk kundër Turqisë*, GJEDNJ-ja vendosi se paraburgimi i një fëmije për një periudhë prej katër muajsh është në kundërshtim me nenin 5(3) të KEDNJ-së.¹²²
103. Në të kundërtën, në rastin *J.M. kundër Danimarkës*, në të cilën një i mitur u mbajt në paraburgim për më shumë se 16 muaj, GJEDNJ-ja nuk gjeti asnjë shkelje të nenit 5(3) të KEDNJ-së. Fëmija ishte vendosur në një institucion të sigurt për shkelësit e rinj, ku u shqyrtua gjendja e tij mendore. Për më tepër, ligjshmëria e paraburgimit të vazhdueshëm u vlerësua rregullisht nga gjykatat vendase. Paraburgimi nuk bazohej vetëm në rëndësinë e akuzës por edhe në reagimin e publikut: do të kishte ofenduar ndjenjën e drejtësisë publike nëse JM, i cili kishte pranuar përdhunimin dhe vrasjen e një gruaje tetëdhjetë e pesë vjeçare, do ishte lëshuar në liri në pritje të përfundimit të ekzaminimeve të gjendjes mendore.¹²³
104. Kur fëmijët mbahen në paraburgim, avokatët duhet t'i referohen Rekomandimit të KE-së (2003)20 lidhur me mënyrat e reja të trajtimit të delikuencës së të miturve dhe rolit të drejtësisë për të mitur.¹²⁴ Theksohet se aty ku fëmijët ndalohen në paraburgim, ata nuk duhet të ndalohen për më shumë se dyzet e tetë orë në total dhe për shkelësit më të rinj duhet të bëhet çdo përpjekje për ta reduktuar këtë kohë.

Zgjidhja e fundit dhe alternativat e paraburgimit

105. Zgjidhja e fundit supozon se privimi i fëmijëve nga liria mund të përdoret vetëm nëse opsionet alternative nuk konsiderohen adekuate ose apo janë dëshmuar si joadekuate nën dritën e objektivave të privimit nga liria. Kjo nënkupton që objektivat e privimit nga liria duhet të jenë të qarta dhe eksplicite në secilën prej tyre. Nëse nuk ka objektiva të qarta, do të jetë e vështirë të vlerësohet domosdoshmëria e vendosjes dhe/ose përdorimit të alternativave.
106. Shtetet anëtare sipas nenit 11 të **Direktivës së fëmijëve** detyrohet që të sigurojnë që masat alternative janë në dispozicion. Masat alternative duhet të jenë në dispozicion në çdo kohë që një

¹¹⁹ Para. 29.

¹²⁰ Para. 36.

¹²¹ Paragrafët 109 dhe 110.

¹²² GJEDNJ *Selçuk kundër Turqisë* (2006), appl. nr. 21768/02, para. 37

¹²³ Para. 62

¹²⁴ Rekomandimi Rec(2003)20 i Komitetit të ministrave të shteteve anëtare në lidhje me mënyrat e reja të trajtimit të delikuencës së të miturve dhe rolit të drejtësisë për të mitur (Miratuar nga Komiteti i Ministrave më 24 shtator 2003 në takimin e 853-të të Zëvendës ministrave), para. 15

fëmijë është në rrezik të ndalohet, duke përfshirë fazat e procedurës paraprake. Alternativat e procedurave paraprake ndaj paraburgimit mund të përfshijnë paralajmërimin e policisë, lirimin me kusht, provën, shërbimin e komunitetit, shqiptimin e gjobave, masat edukative dhe mentorimin, masat e bazuara në kujdes dhe terapeutike si dhe qasjet restauruese.¹²⁵

107. Avokatët duhet të familjarizohen me alternativat e përshtatshme ndaj paraburgimit, në mënyrë që të forcojnë aplikimet në favor të lirit të tyre. Megjithatë, ata duhet të jenë të kujdesshëm që të mos avokojnë për masa apo kushte që janë të papërshtatshme ose të pa punueshme. Për shembull, duke i ekspozuar fëmijët ndaj kushteve të shumta, mund të e bëjnë të vështirë që të kuptohen dhe mbahen në mend të gjitha, dhe kjo mund të vështirësoj përputhshmërinë me këto kushte. Një studim në SHBA zbuloi se fëmijët mbajnë mend vetëm një të tretën e kushteve për lirim të urdhëruara nga gjykata.¹²⁶
108. Është e rëndësishme të theksohet se nuk ka masa të “që si të tilla vlejnë për të gjithë”. Këshillimi dhe kontributi i aktorëve të tjerë (punonjësit socialë, shëndeti mendor dhe ekspertët e tjerë mjekësor në veçanti) është veçanërisht i vlefshëm për ta bërë avokatin dhe autoritetet të jenë në dijeni të alternativës më të mirë në dispozicion për secilin fëmijë dhe të sigurojnë që ekzistojnë aranzhimet e përshtatshme për të siguruar që ai do të lirohet. Në vitin 2017, Ministria e punëve të brendshme të MB-së miratoi një “Konkordat për Fëmijët në Kujdestari”, i cili përmban udhëzime se si akterët e ndryshëm, përfshirë policinë dhe autoritetet lokale, duhet të bashkërendojnë aktivitetet e tyre për të siguruar që fëmijët të mos mbahen në paraburgim për periudha të zgjatura. Konkordati thekson se kufizimet e burimeve, veçanërisht në lidhje me strehimin për fëmijën, nuk përbëjnë bazë për mos sigurimin e nivelit të mbështetjes që është në përputhje me interesat më të mirë të fëmijës.¹²⁷
109. Pavarësisht gamës së gjerë të sanksioneve dhe masave alternative në dispozicion, ende mbeten sfida në inkurajimin e përdorimit maksimal të mundshëm të këtyre alternativave ndaj paraburgimit. Një sfidë kryesore që duhet trajtuar është ajo e inkurajimit të autoriteteve që të përdorin masa alternative. Në shumë vende, paraburgimi shihet ende si opsioni i parë për fëmijët, madje edhe për shkelje të vogla, dhe mbështetja ende vihet në mjetet ndëshkuese të sistemeve tradicionale të drejtësisë penale.¹²⁸ Avokatët duhet të avokojnë për masën që i përgjigjet interesit më të mirë të fëmijës, në mënyrë ideale pas vlerësimit individual dhe/ose ekzaminimit mjekësor në mënyrë që avokati të mund të mbështesë argumentet e tij (shih kapitullin e mëtejshëm mbi vlerësimin e nevojave, në paragrafët. 3.3-3.4).

Shqyrtimi i paraburgimit

110. Vendimet mbi paraburgimin duhet t'i nënshtrohen rishikimit periodik, në kohë të arsyeshme, nga gjykata, me kërkesë të fëmijës ose avokatit.¹²⁹ Një numër i garancive sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut janë relevante në këtë pikë. Komiteti i KDF-së përcakton që kjo duhet të bëhet brenda 24 orëve pas arrestimit dhe ndalimit.¹³⁰ Për më tepër, Komiteti ka rekomanduar që shtetet të sigurojnë përmes dispozitave strikte ligjore që ligjshmëria e paraburgimit të një fëmije të rishikohet rregullisht, mundësisht çdo dy javë.¹³¹ Fëmijët në paraburgim, si të burgosurit e tjerë, kanë të drejtë të nisin procedura me nismën e tyre për të kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit të tyre (me ndihmën e një avokati nëse është e nevojshme).¹³² Komiteti i KDF-së shton se fëmijët kanë të drejtë

¹²⁵ Kilkelly, Forde & Malone 2016.

¹²⁶ Qendra Kombëtare për Mbrojtjen e të Miturve, f. 4.

¹²⁷ https://www.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/655222/Concordat_on_C_hildren_in_Custody_ISBN_Accessible.pdf_p.21 (placeholder reference)

¹²⁸ Kilkelly, Forde & Malone 2016.

¹²⁹ Direktiva e fëmijëve, neni 10(2).

¹³⁰ GC 10, para. 83.

¹³¹ Po aty.

¹³² Neni 9(4) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike dhe neni 37(d) KDF

për një vendim të shpejtë pas një veprimi të tillë, jo më vonë se dy javë pas kundërshtimit.¹³³

E drejta e informimit

111. **Direktiva e fëmijëve** kërkon që fëmijët të informohen si rreth kufizimeve të heqjes së lirisë, ashtu dhe të drejtës së tyre për trajtim specifik gjatë paraburgimit.¹³⁴ Për më tepër, Direktiva për informim siguron që shtetet anëtare të informojnë personat e dyshuar dhe të akuzuar, pavarësisht nga mosha, për numrin maksimal të orëve ose ditëve që ata mund të privohen nga liria përpara se të sillen para një organi gjyqësor.¹³⁵ Njëlloj sikurse me të drejtat tjera të lartpërmendura, avokatët duhet të sigurojnë që informimi për këto të drejta i është siguruar klientëve të tyre fëmijë menjëherë, gojarisht dhe me shkrim, si dhe në një mënyrë që ata e kuptojnë.
112. Stresi i imponuar nga procesi i drejtësisë penale dhe nga paraburgimi ka një ndikim të rëndësishëm në aftësinë e fëmijës për të kuptuar dhe ruajtur informacionin. Gjatë një periudhe ndalimi, një avokat duhet të kujdeset veçanërisht për të siguruar që një fëmijë është i vetëdijshëm dhe e kupton siç duhet situatën në zhvillim dhe mund të marrë pjesë në mënyrë efektive në përgatitjet për një gjykim ose seancë. Mjerisht, në shumë vende, avokatët i vizitojnë klientët e tyre fëmijë në paraburgime shumë rrallë, gjë që ndonjëherë i shton konfuzionin dhe ankthin e tyre dhe disa fëmijë kanë kërkuar të kontaktojnë gjyqtarin apo prokurorin e tyre për të marrë informacion rreth gjykimit të tyre.¹³⁶

Mirëqenia

113. Fëmijët duhet të ndahen veçmas nga të rriturit, përveç nëse konsiderohet të jetë në interesin më të mirë të fëmijës për të mos e bërë këtë.¹³⁷ Shtetet anëtare gjithashtu duhet të ndajnë fëmijët nga të rriturit kur shoqërohen në polici.¹³⁸ Hulumtimet nga Shtetet e Bashkuara tregojnë se fëmijët në institucionet e të rriturve përsërisin shkeljet më shpesh se sa ata të vendosur në institucionet e të miturve. Kjo mund të jetë për shkak të mungesës së shërbimit të moshës dhe mbështetjes në institucionet e të rriturve dhe për shkak të rrezikut më të madh të ndikimit nga të arrestuarit e tjerë.¹³⁹
114. Shtetet anëtare gjithashtu duhet të sigurojnë që fëmijët e ndaluar (a) ruajnë shëndetin e tyre dhe zhvillimin e tyre fizik dhe mendor (b) sigurojnë të drejtën e tyre për arsimim dhe trajnim, duke përfshirë rastet kur fëmijët kanë aftësi të kufizuara fizike, sensore ose të të nxënit; (c) ushtrojnë rregullisht të drejtën e tyre për jetë familjare (d) sigurojnë qasjen në programe që nxisin zhvillimin e tyre dhe riintegrimin e tyre në shoqëri; dhe (e) sigurojnë respektin për lirinë e tyre të fesë ose besimit, të gjitha në përpjesëtim dhe në mënyrë të përshtatshme me kohëzgjatjen e paraburgimit.¹⁴⁰ Prej këtyre kërkesave, (a) dhe (e) zbatohen edhe për ato situata të privimit nga liria përveç paraburgimit (siç është ndalimi në polici). Kërkesat (b), (c), dhe (d) zbatohen për situatat e privimit nga liria përveç paraburgimit, vetëm deri në atë masë që është e përshtatshme dhe proporcionale nën dritën e natyrës dhe kohëzgjatjes së një situatë të tillë. Së fundmi, fëmijët që janë të privuar nga liria duhet të mund të takohen me mbajtësin e përgjegjësishë prindërore sa më shpejt që të jetë e mundur, kur një takim i tillë është në përputhje me kërkesat hetimore dhe operacionale.¹⁴¹

¹³³ GC 10, para. 84.

¹³⁴ Direktiva e fëmijëve, nenet 4(1)(b)(iii), 4(1)(c).

¹³⁵ Neni 4 (2)(d) Direktiva për informim.

¹³⁶ Takimi i ekspertëve të ADRC, korrik 2017, Dokumenti i diskutimit

¹³⁷ Neni 12(1) Direktiva e fëmijëve; Rregulli 29 i Rregullat e Havanës

¹³⁸ Neni 12(2) Direktiva e fëmijëve.

¹³⁹ Ziedenisberg 2011, f. 19.

¹⁴⁰ Neni 12(5) Direktiva e fëmijëve.

¹⁴¹ Neni 12(6) Direktiva e fëmijëve.

Keqtrajtimi

115. Në nivel ndërkombëtar dhe evropian, është duke u rritur ndërgjegjësimi në lidhje me dhunën e përhapur dhe intensive me të cilën ballafaqohen fëmijët në institucione shtetërore, duke përfshirë edhe mbajtjen nga policia.¹⁴² Ky shqetësim pasqyrohet edhe në komentet e përgjithshme të Komitetit të KDF-së, i cili ka pranuar se fëmijët në konflikt me ligjin janë në rrezik më të lartë të dhunës nga ana e zyrtarëve policor, të cilat madje mund shkojnë deri tek tortura.¹⁴³

Në rastin *Zherdev kundër Ukrainës*, GJEDNJ-ja gjeti se zhveshja e rrobave të një fëmije gjatë ndalimit të tij nga policia, pa asnjë shpjegim për mos ofrimin e rrobave të tjera nga ana e autoriteteve, duke e mbajtur atë në një gjendje të tillë për dy orë e gjysmë në një gjendje të pasigurisë dhe më pas duke e vendosur atë në një qeli me të ndaluar të rritur për tre ditë, rezultoi në një shkëlqim të ndalimit të torturës dhe keqtrajtimit sipas nenit 3 të KEDNJ-së.¹⁴⁴ Ndihma nga një avokat është njohur nga GJEDNJ si mekanizëm i rëndësishëm për parandalimin e torturës dhe keqtrajtimit.¹⁴⁵

116. Mbrojtja e mirëqenies së fëmijëve në paraburgim nuk është përgjegjësi vetëm e avokatëve, por avokatët mund të luajnë një rol vendimtar në monitorimin e trajtimit të tyre dhe nëse është e nevojshme, ata duhet të regjistrojnë dhe raportojnë rastet e trajtimit të dobët, në mënyrë që të ndërmerren veprime të përshtatshme. Duhet gjithashtu të theksohet se avokatët mund të monitorojnë dhe raportojnë rastet e trajtimit të dobët nëse ata i vizitojnë rregullisht klientët e tyre fëmijë në paraburgim.

C. Procedurat gjyqësore

117. Varësisht nga situata dhe juridiksioni, qasja e gjykatave ndaj fëmijëve në konflikt me ligjin mund të jetë ndëshkuese ose paternalistike dhe ka shallë të ndryshme në të cilat procedurat gjyqësore janë adaptuar për t'iu përshtatur nevojave të fëmijëve. Mbështetja e fëmijës përgjatë procesit të paraqitjes në gjykatë përfshin menaxhimin e çështjeve duke filluar nga problemet e thjeshta praktike (a mund fëmija të shohë dhe të dëgjojë nga aty ku është ulur?) deri në çështjet më komplekse juridike (nëse një fëmijë ka të drejtë për gjykim publik, ose të mbyllur).
118. Gjyqtarët dhe prokurorët duhet të informohen para fillimit të gjykimit në lidhje me personalitetin dhe nivelin e pjekurisë së fëmijës, si dhe për prejardhjen e tyre ekonomike, sociale dhe familjare, si dhe ndonjë dobësi të veçantë që mund të ketë fëmija. Kjo është thelbësore në mënyrë që të identifikohen përshtatjet e duhura procedurale dhe të bëhen strehime të arsyeshme për t'i shërbyer interesave më të mira të fëmijës. Nëse deri në këtë pikë nuk është kryer vlerësimi individual i nevojave të fëmijës atëherë kjo është absolutisht e nevojshme para fillimit të seancës, megjithëse avokatët duhet të kërkojnë vlerësimin e plotë në një fazë shumë më të hershme (shih paragrafin 5.2.3 më lart).
119. Avokatët, gjyqtarët dhe prokurorët mund të dëshirojnë të dakordohen mbi llojet e përshtatjeve procedurale të nevojshme për seancën gjyqësore si çështje paraprake në fillim të gjykimit. Kjo mund të ndihmojë në shmangien e argumenteve të panevojshme dhe vonësive më vonë në procedurë.

E drejta për informim

120. Sfidat e komunikimit për fëmijët janë të dukshme në sallën e gjyqit. Vështirësitë me ruajtjen e

¹⁴² Raporti i përbashkët 2012, paragrafët. 5, 29, 38-40.

¹⁴³ KDF GC 13, para. 3(i).

¹⁴⁴ GJEDNJ *Zherdev kundër Ukrainës* (2017), appl. Nr. 34015/07, paragrafët 84-95.

¹⁴⁵ GJEDNJ *Salduz kundër Turqisë* (2008), appl. nr. 36391/02, para. 51.

informatave që ndodhin gjatë paraburgimit janë të pranishme edhe në situatat stresuese dhe të shpejta brenda gjykatore. Avokatët duhet të mbajnë në mend se procedura dhe formaliteti i sallës së gjyqit mund të jenë më të vështira për t'u kuptuar për një fëmijë sesa për shumicën e të rriturve. Në studimin e përmendur më lart që është realizuar në SHBA, një e katërta e fëmijëve të anketuar besonin se prokurori nuk ishte i pranishëm në sallën e gjyqit gjatë seancës së tyre ose nuk ishin të sigurt për praninë e tyre.¹⁴⁶

121. Sipas nenit 4 të **Direktivës së fëmijëve**, fëmijët duhet informuar menjëherë rreth aspekteve të përgjithshme të procedurave. Preambula e Direktivës sqaron se në këtë drejtim fëmijëve duhet t'u jepet një shpjegim i shkurtër për hapat e ardhshëm procedural në procedurat për aq sa kjo është e mundur dhe për rolin e autoriteteve të përfshira. Shpjegimi i procesit dhe renditja në të cilën ndodhin fazat e ndryshme do të ndihmojnë fëmijën të kuptojë se çfarë pritet prej tij gjatë procedurave dhe kur ai do të jetë në gjendje t'i japë pikëpamjet e tij gjykatës.¹⁴⁷ Është po aq e rëndësishme të sigurohet që fëmijët të informohen siç duhet gjatë procedurave gjyqësore, në mënyrë që ata të jenë në gjendje t'i ndjekin ato dhe të marrin pjesë aty ku është e përshtatshme. Gjyqtarëve dhe avokatëve mund t'u duhet kohë për t'u shpjeguar fëmijëve se çfarë po ndodh, në mënyrë që ata të mos ndjehen të humbur. Përveç procedurës, avokatët duhet të sigurojnë gjatë gjithë procedurës (por sidomos para dhe gjatë gjykimit) që klientët e tyre fëmijë i kuptojnë akuzat kundër tyre dhe rezultatet e mundshme.

122. Neni 4 gjithashtu përcakton se fëmijët duhet të informohen për të drejtën e tyre për t'u shoqëruar nga një mbajtës i përgjegjësishë prindërore dhe të drejtën për t'u paraqitur personalisht në gjykim. Fëmijët mund të përfshihen në procedurat penale për periudha të gjata dhe mund të kalojnë muaj para se çështja e tyre të mbërrijë në gjykim, gjatë së cilës periudhë ata mund të kenë pasur takime të shumta me policinë. Nuk mund të supozohet se ata kanë mbajtur mend të gjitha informatat që u janë dhënë më parë, përfshirë informatat mbi të drejtat e tyre.¹⁴⁸ Avokatët duhet të mbajnë në mend gjithashtu se fëmijët mund ta kenë më të vështirë se klientët e tjerë që të kuptojnë apo të mbajnë mend informata komplekse rreth situatës së tyre, por edhe të hutohen nga ndryshimet që ndodhin në vazhden e rastit të tyre. Përgjegjësia e informimit të fëmijëve për të drejtat e tyre është një proces i vazhdueshëm, dhe jo një proces që mund të shkarkohet në një moment të caktuar.

Përgatitja për gjykatë

123. Mund të jetë e dobishme për avokatët që të organizojnë vizita në gjykatë për fëmijët, në mënyrë që ata të kuptojnë më mirë planin dhe procedurat e tyre në një mjedis më të relaksuar. Vizita të tilla gjithashtu mund të ndihmojnë fëmijët të ndihen më lehtë gjatë seancës gjyqësore dhe t'i ndihmojnë ata të marrin pjesë në mënyrë më efektive.

124. Një mjet i dobishëm në shpjegimin e procesit të drejtësisë për të mitur, pjesëmarrësit dhe rendin e procedurave që ndodhin në gjykatë, është të vizatojë një skicë të sallës së gjyqit, së bashku me fëmijën. Gjatë vizatimit të skicës, mund të bëhen shpjegime rreth akterëve të ndryshëm dhe rolet e tyre dhe rendi në të cilin ata do të shfaqen ose flasin në gjykatë. Gjithashtu është e rëndësishme t'i shpjegohet fëmijës qëllimi i seancës gjyqësore; çfarë do të vendoset gjatë seancës dhe çfarë është mund të ndodh (p.sh. është një seancë e procedurës paraprake, një seancë dëgjimore në të cilën do të përcaktohet arsyetimi, një shqyrtim i plotë gjyqësor, një seancë shqyrtuese etj.). Përfaqësimi vizual i sallës së gjyqit mund t'u ndihmojë fëmijëve të kuptojnë dhe të mbajnë në mend se çfarë do të ndodhë në gjykatë. Fëmija mund të fotografojë skicën ose të marrë skicën me vete në shtëpi.

¹⁴⁶ Qendra Kombëtare për Mbrojtjen e të Miturve, f. 5.

¹⁴⁷ Liefwaard et al 2016, 64.

¹⁴⁸ Liefwaard et al 2016, 64

E drejta për t'u dëgjuar

125. Shtetet anëtare duhet të sigurojnë që fëmijët të kenë të drejtë të jenë të pranishëm në gjykimin e tyre si dhe duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'u mundësuar atyre që të marrin pjesë në mënyrë efektive në gjykim, duke u dhënë mundësinë që të dëgjohen dhe të shprehin pikëpamjet e tyre 16 (1) **Direktiva e fëmijëve**).

Komunikimi në gjykatore

126. Gjatë seancave gjyqësore, avokatët duhet të monitorojnë nëse fëmija po adresohet në përputhje me nivelin e tij/saj të kuptuarit dhe pjekurisë dhe nëse fëmija e kupton informacionin që i është dhënë atij ashtu që të jetë në gjendje të japë pikëpamjet e tij. Mund të jetë e dobishme për avokatët të vendosin “rregulla bazë” për llojet e pyetjeve që mund dhe nuk mund të bëhen përpara seancës gjyqësore. Nëse një gjyqtar ose prokuror nuk e trajton fëmijën në mënyrë të përshtatshme gjatë shqyrtimit, avokati duhet të ndërhyjë, duke theksuar nivelin e të kuptuarit dhe pjekurisë e fëmijës, të nënvizojë rëndësinë e pjesëmarrjes së fëmijës në gjykim dhe t'u kërkojë atyre që të përshtatin gjuhën në një mënyrë miqësore për fëmijët. Mund të jetë veçanërisht sfiduese për të siguruar pjesëmarrjen efektive të fëmijëve në sistemet ligjore që kanë procedura kontradiktore që lejojnë marrjen e tërthortë në pyetje të fëmijëve.

127. Varësisht nga rrethanat, përshtatjet të cilat avokatët dëshirojnë të bëjnë mund të përfshijnë:¹⁴⁹

- Dakordimin që të mos përdoren pyetje të cilat e ngarkojnë rastin e ngritur nga prokurori mbi fëmijën (për shembull, “ti e ke vjedhur biçikletën, apo jo?”; “ke dalë nga shtëpia para orës 7, apo jo?”);
- Dakordimi për të përdorur pyetje të shkurtra dhe të thjeshta;
- Dakordimi për të mos përdorur teknika agresive të marrjes në pyetje që synojnë të ushtrojnë presion mbi fëmijën;
- Vendosja e afateve kohore për pyetje; dhe
- Përdorimi i ndihmave vizuale, të tilla si modelet dhe planet e trupit

128. Avokatët mund të kenë nevojë për ndihmë shtesë për të siguruar që fëmijët janë në gjendje të komunikojnë në mënyrë efektive me gjykatën dhe ata mund të dëshirojnë të marrin parasysht kërkimin e ndihmës së një ndërmjetësuesi për të ndihmuar ‘interpretimin’ e fëmijës.

Përshtatje praktike

129. E drejta për t'u dëgjuar nuk lehtësohet vetëm duke siguruar që fëmijët janë në gjendje të kuptojnë dhe të përgjigjen, por duke krijuar një atmosferë në të cilën ata mund të shprehin sa më shumë të jetë e mundur, pa ndjenja të frikësimit dhe ngurrimit.¹⁵⁰ Shumica e sallave të gjykimit dhe procedurave nuk janë krijuar duke pasur në mendje interesat e fëmijëve, dhe avokatëve mund t'ju duhet të kërkojnë përshtatje të ndryshme praktike në mënyrë që klientët e tyre të jenë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë efektive dhe të dëgjohen. Këto mund të përfshijnë:

- Lejimi i fëmijëve të ulen pranë ose afër prindërve të tyre;
- Lejimi i fëmijëve të ulen pranë avokatit të tyre;
- Të ulen të gjitha palët në të njëjtin nivel me fëmijën;
- Heqja e pelerinave dhe parukave, ose veshjeve të tjera “të pazakonta” në sallën e gjykimit; dhe
- Në disa shtete, mund të jetë e mundur që të organizohet që seanca gjyqësore të mbahet në vendin ku fëmija është i ndaluar, kështu që ai nuk ka nevojë të përshtatet në një mjedis të panjohur.

¹⁴⁹ Këta shembuj janë përshtatur nga Rregullat e Procedurës Penale të Anglisë dhe Uellsit, 3.9(7)(b)

¹⁵⁰ T v. *Mbretëria e Bashkuar*, para. 85; shih gjithashtu Rregullat e Pekinit, Rregulla 14.2.

130. Gjithashtu, është e rëndësishme të sigurohet se seanca gjyqësore zhvillohet në përputhje me një afat kohor që merr parasysh pamundësinë e një fëmije për t'u përqendruar për periudha të gjata. Kjo do të thotë që aty ku është e mundur, duhet të shmangen procedurat e gjata, dhe duhet të bëhen pushime të rregullta.

Mbrojtja e privatësisë

131. Publiciteti mund të ketë efekt shumë të dëmshëm ndaj të dyshuarve fëmijë dhe personave të akuzuar, dhe jo vetëm sepse ndikon në mirëqenien dhe rehabilitimin e tyre. E drejta për privatësi në procedurat gjyqësore për të mitur është e mbrojtur në përputhje me KDF-në.¹⁵¹ Megjithatë, është pranuar gjithashtu se nevoja për të mbrojtur privatësinë e fëmijëve gjatë procedurës penale duhet të jetë e balancuar kundrejt të drejtës për një seancë të hapur, siç është e mbrojtur me nenin 6 të KEDNJ-së.¹⁵²

132. Komiteti i KDF ka pranuar se si rregull i përgjithshëm, seancat gjyqësore duhet të bëhen në mënyrë private, por mund të ketë përjashtime “shumë të kufizuara” ndaj këtij rregulli.¹⁵³ Ky opinion reflektohet në një farë mase në nenin 14 të **Direktivës së fëmijëve**, e cila parasheh se pjesëmarrja në seanca gjyqësore duhet të mbahet private, dhe që gjykatat të lejojnë shqyrtimet e tilla të bëhen në mënyrë private. Kjo është një dispozitë e formuluar shumë qartë, dhe preambula e Direktivës sugjeron që kjo është për shkak të dallimeve në sistemet ligjore të shteteve anëtare.¹⁵⁴

133. GJEDNJ-ja shqyrtoi çështjen e seancave gjyqësore private që përfshinin fëmijët në rastet *T kundër Mbretërisë së Bashkuar* dhe *V kundër Mbretërisë së Bashkuar*. T dhe V, të cilët ishin fëmijë të moshës 10 vjeçare në kohën e krimit dhe 11 në kohën e gjykimit, u dënuan për vrasje. Edhe pse u përdorën një numër masash të veçanta, gjykimi ishte publik, dhe emrat e fëmijëve u botuan pas dënimit të tyre. Ndërsa, duke njohur interesimin për administrim të hapur të drejtësisë, GJEDNJ-ja theksoi se ky interesim do mund të ishte përmbushur duke përcaktuar “të drejtën e pjesëmarrjes së përzgjedhur” dhe “raportim të matur”. Me fjalë të tjera, edhe nëse interesat e drejtësisë kërkojnë që gjykimet që përfshijnë fëmijët të mbahen në publik, duhet të ketë kufizime për hapjen e këtyre gjykimeve. Avokatët duhet të theksojnë gjithashtu se Komiteti i KDF-së dhe Rregullat e Pekinit kanë deklaruar se identiteti i fëmijës duhet të mbahet anonim.¹⁵⁵

134. Avokatët mund të mos jenë gjithmonë në gjendje të sigurojnë që gjykimet që përfshijnë fëmijët e akuzuar janë tërësisht të mbyllura për publikun dhe mund të mos jenë në gjendje të përjashtojnë anëtarët e shtypit, por duhet të sigurojnë që qasja publike në procedurat gjyqësore është e kufizuar dhe se identiteti i fëmijës mbetet i panjohur për publikun.

Pas seancës dëgjimore

135. Pas përfundimit të seancës dëgjimore, avokatët duhet të mbajnë në mend që t'i shpjegojnë fëmijës rezultatin dhe implikimet e mundshme të vendimit. Kur merret një vendim kundër dëshirës së një fëmije, është e rëndësishme që ai të kuptojë se si është marrë vendimi dhe shkalla në të cilën pikëpamjet e tij kanë luajtur rol në vlerësim dhe se çfarë do të thotë vendimi për të.¹⁵⁶ Shpjegimi i rezultatit është i një rëndësie të madhe për shkak se mund t'i ndihmojë fëmijës që të kuptojë pasojat e sjelljes së tij si dhe të ndihmojë atë në "pranimin" e vendimit.¹⁵⁷ Një shpjegim i kuptueshëm i arsyeve të një vendimi të caktuar çon në një pasqyrë më të mirë e fëmijës për sjelljen e tij delikuede.

¹⁵¹ Neni 40(2)(b)(vii).

¹⁵² Cras 2016, 118.

¹⁵³ GC 10, para. 66.

¹⁵⁴ Direktiva e fëmijëve, Recitali 56.

¹⁵⁵ GC 10, para 66; Rregullat e Pekinit, Regulla 8.

¹⁵⁶ Archard & Skivenes, 2009

¹⁵⁷ Rap, 2013, Cashmore & Parkinson, 2007; Schuytplot, 1999; Tyler, 2006; 2003

136. Shpjegimi i arsyeve të një vendimi të caktuar dhe përmbajtja konkrete e vendimit duhet të bëhet në një mënyrë dhe gjuhë që është e kuptueshme për fëmijën. Fëmijët shpesh nuk i kuptojnë pasojat e një vendimi të caktuar ligjor, sidomos kur ata janë shkelës për herë të parë.¹⁵⁸ Për shembull, shpesh është e paqartë për një fëmijë se çfarë përfshin një dënim në komunitet (p.sh. kur duhet të kryejë shërbim në komunitet, çfarë pune do të jetë, në ç'vend dhe sa kohë duhet për të përfunduar masën).

Apelet

137. Për më tepër, është e rëndësishme që fëmija të marrë informatat mbi mundësitë e apelimit kundër vendimit të marrë. Neni 40(2)(b)(v) KDF parashikon që fëmija ka të drejtë të kërkojë rishqyrtim të vendimit dhe masave të vendosura t nga një organ më i lartë kompetent, i pavarur dhe i paanshëm.¹⁵⁹ Në *Udhëzuesin mbi Drejtësinë miqësore ndaj fëmijëve* thuhet se avokati i fëmijës, kujdestari *ad litem* ose përfaqësuesi ligjor duhet të japë informacionin e nevojshëm lidhur me ankesën, pasi që fëmijës t'i jetë dhënë vendimi ose gjykimi.¹⁶⁰ Një takim privat me fëmijën pas seancës gjyqësore është gjithashtu me rëndësi për të diskutuar me të mundësitë e apelimit dhe këshillimin e fëmijës për këtë çështje.

V. PËRFUNDIM

138. Qëllimi kryesor i këtij Udhëzuesi është të ofrojë udhëzime për avokatët që punojnë me fëmijët në konflikt me ligjin si pjesë e praktikës së tyre të përditshme. Ai ka për qëllim që të mbështesë juristët në përdorimin e Direktivës së Fëmijëve për të kërkuar dhe mbrojtur të drejtat e klientëve të tyre.

139. Megjithatë, ne i inkurajojmë anëtarët e rrjetit LEAP dhe juristët tjerë që të identifikojnë problemet e vazhdueshme me ligjin dhe praktikën kombëtare, veçanërisht kur dispozitat e Direktivës ose zbatimi i tyre ofrojnë mbrojtje jo të plotë në nivel kombëtar. Shkëmbimi i këtij informacioni na mundëson që të shqyrtojmë mundësinë e përdorimit të procesit gjyqësor strategjik për të sqaruar kuptimin e Direktivës në një mënyrë që rrit mbrojtjen që i jepet të drejtave të gjyqimit të drejtë, ose për të ndikuar ndryshe në lëvizjen drejt një mbrojtjeje më të gjerë të të dyshuarve të cenueshëm përmes legjislacioni evropian dhe kombëtar.

140. Për më tepër, përderisa ky udhëzues synon të qëndrojë i vetëm si burim informacioni dhe udhëzimi për përdorimin e Direktivës së Fëmijëve, puna efektive me të dyshuarit fëmijë në mënyrë rutinore kërkon aftësi dhe njohuri përtej kufijve të trajnimit ligjor. Për këtë arsye, Fair Trials kanë zhvilluar dhe pilotuar një program trajnimi më holistik të titulluar *“Avancimi i të Drejtave të Mbrojtjes së Fëmijëve”*, i cili përfshin informata mbi zhvillimin e adoleshentëve dhe materialeve të dizajnuara për të zhvilluar aftësitë e buta të nevojshme për të punuar me sukses me fëmijët në stres. Më shumë informacion mbi këtë program trajnimi, përfshirë edhe linqet me modulën online të trajnimit që shogëron trajnimin, është në dispozicion [këtu](#).

141. Praktikuesit që kërkojnë informata të mëtejshme rreth të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin, dhe udhëzimeve praktike hap pas hapi për të ndihmuar klientët e tyre fëmijë, inkurajohen të konsultohen me udhëzimet praktike të prodhuara nga *“Defence for Children International”* (*‘DCI’*).¹⁶¹ DCI-ja gjithashtu ka prodhuar një manual për shtetet anëtare për të ndihmuar në zbatimin

¹⁵⁸ Plotnikoff & Woolfson, 2002

¹⁵⁹ Shih gjithashtu GC 10, paragrafët. 60-61

¹⁶⁰ Udhëzuesi, Para. 75

¹⁶¹ DCI-Belgium, ‘Udhëzuesi Praktik për Avokatët - Si të mbrosh një fëmijë në konflikt me ligjin?’, E qasshme në: <http://www.mylawyermyrights.eu/wp-content/uploads/2016/05/PRACTICAL-GUIDE-FOR-LAWYERS.pdf>

e Direktivës së Fëmijëve dhe standardeve të tjera ndërkombëtare për drejtësinë për të mitur.¹⁶²

142. Ky Udhëzues do të shpërndalet tek mijëra avokatë anembanë Evropës, ku të gjithë ftohen të:

- [Kontaktimi me ne](#), dhe na tregoni për përvojat e juaja në përdorimin e direktivës në praktikën tuaj të përditshme.
- Na tregoni nëse gjykatat nxjerrin vendime pozitive në dritën e Direktivës. Këto mund të jenë të dobishme për njerëzit në vende të tjera.
- Vizitoni rregullisht faqen tonë të internetit www.fairtrials.org për përditësime mbi zhvillimet kyçe në lidhje me Direktivat, si dhe lajmet mbi trajnimet personale.

LEAP
Fair Trials P
ranverë 2018

¹⁶² DCI-Belgium, 'Manuali për shtetet anëtare - Si të sigurohen të drejtat e fëmijëve në konflikt me ligjin? ', E qasshme në: http://www.mylawyermyrights.eu/wp-content/uploads/2016/05/MANUAL-FOR-EU- MS_Web_EN.pdf